

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6095
E hënë, 24 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Sot takohen liderët e koalicionit qeverisës

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATON ABDULLAHU | FAQE 4-5

QEVERIA HOTI ËSHTË E HUTUAR



Njohësi i rrethanave politike, Faton Abdullahu, ka bërë me dije se qeveria Hoti më shumë se çdo qeveri tjetër është e hutuar. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kjo

po ndodh për shkak të mosunitetit të partnerëve brenda koalicionit qeverisës. Sipas tij, përgjegjësia më e madhe për mospasjen e unitetit në këtë koalicion bie mbi LDK-në e cila ka marrë më së

shumti përgjegjësi. Ai e ka ftuar spektrin politik në vend që të bashkohet në procesin e dialogut me Serbinë. Abdullahu ka thënë se të përçarëve nuk u ndihmon as Zoti e as Amerika

KËRKOHET TË HIQEN KUSHTËZIMET PËR REGJISTRIMIN E AUTOMJETEVE

Qytetarët e Kosovës për të pasur të drejtë që ta regjistrojnë automjetin e tyre janë të kushtëzuar që t'i paguajnë shpenzimet komunale dhe gjokat në trafik. Në Kosovë llogaritet të jenë të

paregjistruara 148 mijë automjete, kurse vetëm në bazë të pagesave komunale me rastin e ndërrimit të pronësisë së automjeteve llogaritet që qytetarëve të Kosovës kjo do t'u kushtojë miliona euro. Këto



kushtëzime janë kundërshtuar nga kryetari i Shoqatës "Konsumatori", Selatin Kaçaniku dhe kryetari i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku | FAQE 4-5

DHJETË TË VDEKUR DHE 111 RASTE TË REJA ME COVID-19 NË KOSOVË | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS KA SJELLË VETËM LAVDI (34) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

QYTETARËT KËRKOJNË KTHIMIN E NXËNËSVE NË SHKOLLA, KUNDËRSHTOJNË MËSIMIN "ONLINE" F. 6

QEVERIA KRITIKOHET NGA SHOQËRIA CIVILE PËR MUNGESË TË TRANSPARENCËS F. 5

VAZHDON TË JETË I NDALUAR QËNDRIMI PËRRETH LIQENIT TË RADONIQIT F. 7

EKONOMI

THAÇI: JEMI TË BEKUAR ME BEREQETIN E TOKËS SONË F. 9

MUSTAFA: BRENDA MUNDËSIVE DO T'I KOMPENSOJMË DËMET E SHKAKTUARA NGA BRESHRI F. 9

70 PËR QIND E BIZNESEVE HOTELIERE PUNOJNË ME HUMBJE F. 8

SPORT

PRISHTINA PRET VENDIM TË DREJTË NGA UEFA F. 8

Vajza e Azem Hajdarit pritet të formojë parti të re



Tiranë, 23 gusht (ER) - Ishte bërë deputete nga lista e Partisë Demokratike (PD) dhe kur partia e saj dogji mandatet, Rudina Hajdari ka qëndruar në Kuvend, ndërsa tani ajo do ta formojë partinë e vet. Hajdari do ta zyrtarizojë lëvizjen e re politike për të garuar në zgjedhjet e 2021-s. Vajza e Azem Hajdarit, njërit nga themeluesit e PD-së, ka thënë se projektin e ri politik

është duke e përgatitur me ajkën e shoqërisë, ndërsa objektivi i saj do të jetë rinia, me të cilën shpreson ta bëjë ndryshimin. "Beteja për hapjen e listave u fitua falë mbështetjes së shumicës absolute të shqiptarëve. Jam e bindur se do t'i hapim 100 për qind. Uroj që të njëjtën mbështetje ta ketë edhe për projektin e ri politik, i cili do ta synojë bashkimin e tyre, që

duan punën e ndershme dhe e shohin të ardhmen në këtë vend, kundër atyre pak të pangopurve që kanë 30 vjet që majmen në kurriz të djerësës së shqiptarit të ndershëm. Jam e bindur se projektin e ri politik që po përgatisim me ajkën e qytetarisë do ta bashkojë së pari rininë studentore e cila ka qenë gjithnjë në krye të ndryshimit", ka thënë Hajdari.

Kompletohet kabineti qeveritar në Maqedoni, pritet caktimi i seancës për votim

SHKUP, 23 GUSHT - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) më në fund ka publikuar edhe emrin e ministrit të ri të Shoqërisë Informatike dhe Administratës me çka është kompletuar edhe përbërja e qeverisë së re e cila duhet të zgjidhet në Kuvend. Propozimi i tyre është Jeton Shaqiri, profesor i Universitetit Ndërkombëtar në Strugë. Afati për shtrimin e propozimit për zgjedhjen e qeverisë së re skadon më 2 shtator. Pasi të premten Talat Xhaferi është rizgjedhur kryetar i Kuvendit, ditët në vijim pritet të caktohet seanca për zgjedhjen e qeverisë së re. Në qeverinë e re, siç ka paralajmëruar mandatarin Zoran Zaev, do të jenë 19 ministra apo shtatë më pak se në të kaluarën. Propozimet për ministrat e rinj janë publikuar të mërkurën pasi paraprakisht ishte zyrtarizuar koalicioni midis LSDM-së dhe BDI-së. Nga radhët e LSDM-së në përbërje të qeverisë së re hyjnë

Oliver Spasovski, i cili do ta drejtojë Ministrinë e Punëve të Brendshme; Radmilla Shekerinska, e cila do të vazhdojë ta udhëheqë Ministrinë e Mbrojtjes, ndërsa ministër i ri i Drejtësisë është propozuar Bojan Mariçiq. Bllagoj Boçvarski do ta drejtojë Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, Jagoda Shahpaska, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa Irena Stefkova do të jetë ministre e re e Kulturës. Venko Filipçe do të mbetet ministër i Shëndetësisë, ndërsa zëvendëskryeministrja Milla Carovska do ta drejtojë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Shefi i deritanishëm i diplomacisë, Nikolla Dimitrov, do të jetë zëvendëskryeministër i obliguar për Çështje Evropiane. Fatmir Bytyqi do të jetë zëvendëskryeministër për Çështje Ekonomike, ndërsa Lupço Nikolovski zëvendëskryeministër për luftë kundër korrupsionit. Ndërsa BDI-ja do t'i drejtojë Ministrinë



e Financave, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Mjedisit Jetësor. Do të ketë edhe zëvendëskryeministër dhe ministër për sistem politik. Propozimi i BDI-së është që

Artan Grubi të jetë zëvendëskryeministër dhe ministër për sistem politik, Fatmir Besimi ministër i Financave, Bujar Osmani i Punëve të Jashtme, Kreshnik Bekteshi, ministër i Ekonomisë

dhe Naser Nuredini i Mjedisit Jetësor. Kujtojmë se Florin Besimi ka dhënë dorëheqje nga pozita e deputetit nga radhët e BDI-së. Vendin e tij pritet ta zë Bedri Fazliu. /Alsat-M/

Basha: Shqipëria do të jetë si gjithë Evropa, demokratike dhe e lirë

TIRANË, 23 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, në Ditën Evropiane të Kujtesës së Viktimave të Sistemeve Totalitare, ka thënë se projektin e saj për kthim pas në epokën e pushtetit absolut për të kontrolluar gjithçka me oligarkë e kriminalë do ta marrë përgjigjen e merituar nga shqiptarët. Ai ka thënë se Shqipëria do të jetë si gjithë Evropa, demokratike, e lirë, e zhvilluar ekonomikisht, me mundësi dhe shanse për të gjithë shqiptarët. "23 gushti është Dita e Kujtesës për Viktimat e Sistemeve Totalitare, por edhe paralajmërim për të gjithë ata që keqpërdorin vullnetin e pop-

ullit në përpjekje për ta rivendosur autoritarizmin. Kujtesa dhe respekti për mijëra viktimat e sistemit më të egër komunist në Evropë duhet dhe do të jetë pjesë e rëndësishme e historisë moderne të Shqipërisë. Vuajtjet dhe mohimi i të drejtave themelore të shqiptarëve gjatë diktaturës, sakrificat e mijëra familjeve shqiptare në komunizëm, janë udhërrëfyeni më i mirë për ta vulosur pas 30 vjetësh tranzicion, sistemin e vlerave të demokracisë evropiane. Projektin ogurzi i kthimit pas në epokën e pushtetit absolut, i kontrollit të gjithçkaje në vend nga një grusht pushtetarësh të lidhur me një grusht oligarkësh dhe krim-



inelësh, projektin e rrënimit të lirisë, demokracisë dhe ekonomisë si dhe zbrazjes së vendit, do ta marrë përgjigjen e merituar nga qytetarët shqiptarë", ka thënë Basha. Ai ka thënë se PD-ja është në

krahë të mbijetuarve dhe familjarëve të viktimave të diktaturës dhe e vendosur që ta shkatërrojë projektin e rikthimit të shqiptarëve në skllavëri kolektive "Partia Demokratike është në krahë

të të mbijetuarve dhe familjarëve të viktimave të diktaturës, në krahë të rinisë, intelektualëve dhe shtresës së mesme, sipërmarrjes dhe fermerëve shqiptarë, e vendosur për ta shkatërruar projektin e rikthimit të shqiptarëve në një skllavëri kolektive në shërbim të një pakice. Historia e re e Evropës është dëshmi e qartë e fundit pa lavdi të çdokujt që është përpjekur të sundojë me forcën e autoritarizmit. I tillë është fundi i këtij projekti, projektuesve dhe ndihmësve të tij. Shqipëria do të jetë si gjithë Evropa, demokratike, e lirë, e zhvilluar ekonomikisht, me mundësi dhe shanse për të gjithë shqiptarët", është shprehur Basha.

Pas një kohe të gjatë liderët e koalicionit do të diskutojnë për disa çështje

Sot takohen liderët e koalicionit qeverisës

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ai i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, do të takohen sot (e hënë) për të biseduar për të gjitha çështjet e hapura të koalicionit qeverisës. Zyrtarët e këtyre partive kanë deklaruar se liderët e koalicionit qeverisës do të diskutojnë për procesin e dialogut Kosovë - Serbi dhe për çështjen e pozitës të presidentit të vendit e cila është hapur së fundi. Përveç AAK-së, tani edhe partia më e madhe e koalicionit, LDK-ja, ka shprehur ambiciet për president

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 GUSHT - Liderët e koalicionit qeverisës do të takohen sot (e hënë) në orën 14:00. Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në këtë takim priten të flasin për mospajtimet rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi dhe për çështjen e postit të presidentit të vendit e cila është hapur pasi Ramush Haradinaj ka shprehur ambicie për këtë post.

Sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Arban Abrashi, ka bërë me dije se në këtë takim do të diskutohen të gjitha çështjet e hapura. "Kemi parë deklarata që shumë shpesh kanë marrë edhe vëmendje mediatike, qoftë të liderit të AAK-së, qoftë

të tjerëve. Qoftë edhe për pozita të ndryshme për mbarëvajtje të koalicionit ose për qasjen e qeverisë karshi dialogut e kështu me radhë. Ideja është që të ulen krerët e partive. Thjesht, një takim i cili do t'i trajtojë të gjitha çështjet e hapura, duke përfshirë edhe mënyrën e dialogut dhe çështjen e presidentit", ka deklaruar ai për "Kosovapress". Madje ai ka thënë se posti i presidentit i takon kësaj partie. "Nuk është diskutuar asnjëherë se cilës parti duhet t'i takojë, por unë besoj se edhe LDK-ja si një parti shtet-formuese, e cila ka dhënë shumë për vendin, edhe i ka numrat në Kuvend, besoj se mund t'i takojë posti i presidentit", ka theksuar Abrashi.

Ditë me parë Këshilli Drejtues i AAK-së ia ka dhënë besimin Ramush Haradinajt që të jetë

kandidat për president. Më pas Haradinaj ka treguar arsyet se pse e synon këtë post. "Aleanca është para dy zgjidhjeve, të dyja shumë të vështira. E para është që të vazhdojë të jetë pjesë e pushtetit dhe e vendimmarrjes, por ta kushtëzojë me marrjen e një pozicioni vendimmarrës të presidentit. Dhe kjo është logjika pse Këshilli Drejtues i AAK-së më ka dhënë autorizim të negociojë edhe për çështjen e presidentit, me qëllim që ne të mos përjashtohemi nga tavolina e marrjes së vendimeve", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, me marrjen e pozitës së presidentit AAK-ja nuk e rrit pushtetin e

vet. "Ne vetëm ruajmë mundësinë e të qenit në tavolinë aty ku merren vendimet. Në rast se ne nuk e marrim presidentin tani, meqenëse jemi parti më e vogël, PDK-ja dhe LDK-ja, në emër të një shumice në Kuvend, mund të na mbivotojnë në çdo situatë e në tema të interesit nacional. Në këtë rast, tani situata është e ndjeshme jo me LDK-në, sepse LDK-ja nuk mund t'i ketë dy përgjegjësitë e para, edhe kryetarin e qeverisë, edhe presidentin. E LDK-ja, në fakt, nuk ka shprehur ambicie", ka thënë Haradinaj. Takimi i liderëve të partive të koalicionit ishte paraparë të

mbahej të enjten, por është shtyrë për të hënë. Më herët edhe nga AKR-ja kanë thënë se kandidat i tyre është Behgjet Pacolli, lider i kësaj partie.

Kurse njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se, nëse ndodh zgjerimi i koalicionit qeverisës me PDK-në, ky post mund t'i takojë kësaj partie. Madje, sipas tyre, PDK-ja këtë post mund ta marrë edhe nëse vendos ta mbështesë qeverinë në disa procese, pa u futur në qeveri. President i vendit është Hashim Thaçi dhe mandati i tij përfundon në pranverë, por mund të japë edhe dorëheqje nëse i konfirmohet aktakuza nga Gjykata Speciale.

Policia e Kosovës u jep mirënjohje karabinierëve italianë të KFOR-it

PRISHTINË, 23 GUSHT - Karabinierëve italianë, të cilët i përkasin Njesisë së Specializuar Shumëkombëshe të KFOR-it nga Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës në Mitrovicën e Jugut, u është dhënë një mirënjohje për kontributin aktiv për përmblylljen e shpejtë të një çështje penale. Në fund të korrikut, ekipi i karabinierëve, i vendosur zakonisht në urën e Ibrit në Mitrovicë, ka shpëtuar një grua që kishte ikur nga një rrëmbim dhe kishte thirrur për ndërhyrje Policinë e Kosovës. Ushtarët italianë më pas mbështetën hetimet vendore që, falë Ambasadës Italiane, ka çuar në arrestimin e rrëmbyesit të dyshuar, një qytetar italian-kosovar.

Njësia e specializuar shumëkombëshe e KFOR-it operon në mënyrë të paanshme në mbarë Kosovën për të kontribuar për një mjedis të qetë dhe të sigurt dhe për lirinë e lëvizjes për të gjithë qytetarët në Kosovë në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së të vitit 1999. Për më tepër, karabinierët italianë, në bashkërendim të ngushtë me Kryqin e Kuq, kanë zhvilluar projekte të ndihmës në favor të të gjitha komuniteteve në Kosovë, brenda kornizës së aktiviteteve civile-ushtarake të KFOR-it në mbështetje të institucioneve shëndetësore dhe arsimore, si dhe të përgjigjes vendore ndaj Covid-19.





Flet për “Epokën e re”, Faton Abdullahu

Qeveria Hoti është e hutuar

Njohësi i rrethanave politike, Faton Abdullahu, ka bërë me dije se qeveria Hoti më shumë se çdo qeveri tjetër është e hutuar. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se kjo po ndodh për shkak të mosunitetit të partnerëve brenda koalicionit qeverisës. Sipas tij, përgjegjësia më e madhe për mospasjen e unitetit në këtë koalicion bie mbi LDK-në e cila ka marrë më së shumti përgjegjësi. Ai e ka ftuar spektrin politik në vend që të bashkohet në procesin e dialogut me Serbinë. Abdullahu ka thënë se të përçarëve nuk u ndihmon as Zoti e as Amerika

mundësitë që të përfitojmë ndonjë gjë nga dialogu me Serbinë. E pakuptueshme prej nga kjo prirje noshalante për të mos u bërë bashkë së paku në përballje me Serbinë. Të përçarëve nuk u ndihmon as zoti e as Amerika”, ka deklaruar Abdullahu.

shukur sa më shumë pushtet. Nuk shpresoj shumë se kjo do të tejkalohet lehtë ndërmjet partnerëve të koalicionit aktual.

“Epoka e re”: Si i keni parë mospajtimet e deritashme të AAK-së me LDK-në për dialogun me Serbinë dhe disa çështje të tjera?

Abdullahu: Përgjegjësia më e madhe për mospasjen e unitetit në këtë koalicion i bie atij që ka marrë më së shumti përgjegjësi, pra LDK-së. LDK-ja, si duket, ka edhe ambicie të tjera që nuk mund të përmbushen vetëm përbrenda këtij koalicioni. Ajo mendon dhe punon edhe për dimensione të tjera pushtetare të cilat nuk janë krejt përbrenda kësaj qeverie. E para që është e interesuar të mos vazhdohet kështu si është kjo qeveri është LDK-ja, sado që për këtë po mundohet t’ia vë fajin sidomos AAK-së dhe kjo po i shkon për dore. LDK-ja vazhdon hezitimin e saj ta prezantojë si maturi politike e në të vërtetë kjo është vonësë dhe pengesë për do gjë. Prandaj qeveria Hoti, më shumë se çfarëdo tjetër, është qeveri e hutuar.

“Epoka e re”: Pas AAK-së, edhe LDK-ja ka shprehur dëshirën

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 GUSHT - Analisti politik Faton Abdullahu e ka kritikuar qeverinë Hoti për mosunitet brenda koalicionit qeverisës. Ai ka thënë se përgjegjësia më e madhe për mospasjen e unitetit në këtë koalicion i bie LDK-së si parti që ka marrë më së shumti përgjegjësi. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Abdullahu ka thënë se LDK-ja ka edhe ambicie të tjera që nuk mund të përmbushen vetëm përbrenda këtij koalicioni. “Ajo mendon dhe punon edhe për dimensione të tjera pushtetare të cilat nuk janë krejt përbrenda kësaj qeverie. E para që është e interesuar të mos vazhdohet kështu si është kjo qeveri është LDK-ja, sado që për këtë po

mundohet t’i vë fajin sidomos AAK-së dhe kjo po i shkon për dore. LDK-ja vazhdon hezitimin ta prezantojë si maturi politike e në të vërtetë kjo është vonësë dhe pengesë për do gjë. Prandaj qeveria Hoti më shumë se çfarëdo tjetër është qeveri e hutuar”, ka thënë ai.

Abdullahu ka bërë me dije se LDK-ja para AAK-së e ka kërkuar postin e presidentit. Sipas tij, për këtë gjë LDK-ja ka kohë që punon. “LDK-ja e do më shumë se cilado parti tjetër postin e presidentit. ka kohë që kalkulohet kjo pozitë dhe për këtë punohet. Këtë nuk është e lehtë për ta kuptuar sepse për dallim nga AAK-ja, këtë LDK-ja e kamuflon me prirjen prej një tuxharllëku që hesapet i bën, por ato nuk ia tregojnë askujt. Është marrëzi jo vetëm politike

kur e mendon se sa energji po shpenzohet për këtë post, sa përçarje po ndillet për diçka që, megjithatë, nuk dihet se a fillon e si do të përfundojë”, është shprehur ai, duke shtuar se ky koalicion qeverisës po hyn në gjynah me qytetarin.

Në këtë intervistë, ai ka folur edhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, ku e ka kritikuar spektrin politik për mosunitet rreth kësaj çështje. Abdullahu ka deklaruar se sa më të përçarë aq më shumë do të zvogëlohen mundësitë e Kosovës që të përfitojë ndonjë gjë nga dialogu me Serbinë. “Po vazhdojmë të mos jemi unikë si në këtë qeveri, si në atë para kësaj, edhe përkundër faktit se po bindemi pandalshëm sa agresive, por edhe e bashkuar është Serbia kundër nesh. Sa më të përçarë aq më shumë do të zvogëlohen

“Epoka e re”: Z. Abdullahu, sot (e hënë) liderët e partive politike të koalicionit takohen për t’i diskutuar disa çështje për të cilat partnerët kanë shprehur mospajtime prej kohësh. Si pritni të shkojë ky takim?

Abdullahu: Po vazhdojmë të mos jemi unikë si në këtë qeveri, si në atë para kësaj edhe përkundër faktit se po bindemi pandalshëm sa agresive, por edhe e bashkuar është Serbia kundër nesh. Sa më të përçarë aq më shumë do të zvogëlohen mundësitë që të përfitojmë ndonjë gjë nga dialogu me Serbinë. E pakuptueshme prej nga kjo prirje noshalante për të mos u bërë bashkë së paku në përballje me Serbinë. Të përçarëve nuk u ndihmon as zoti e as Amerika. Shqiptarëve u është rikthyer një e metë e vjetër ku, inati po u bëhet më i madh se arsyeja e ky inat u vjen si duket nga grykësia për të

Qeveria kritikohet nga shoqëria civile për mungesë të transparencës

PRISHTINË, 23 GUSHT - Kosova edhe më tej është duke u përpjekur që të ndërtojë institucione transparente dhe llogaridhënese por, sipas përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, institucionet qeveritare dhe ndërmarrjet që janë në pronësi publike ende vuajnë nga mungesa e transparencës.

Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë e Lëvizjes FOL, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", thotë se po bëhen gati 100 ditë të qeverisë të udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti dhe, sipas saj, kjo qeveri ende nuk ka emëruar zëdhënësin, i cili konsiderohet një urë lidhëse mes qeverisë dhe shoqërisë civile. "Marrë parasysh edhe gjendjen aktuale shkaku i pandemisë, shumë vendime kjo qeveri i ka marrë, por nuk janë prezantuar para qytetarëve në mënyrën e duhur. Sa i përket takimit të 4 shtatorit në ShBA, mendoj se duhet të kemi një transparencë më të madhe rreth këtij takimi. Është thënë se do të ketë një 'Ekip të Unitetit', por ende gjithçka është në mjegull, pra nuk kemi informata nga qeveria se sa është punuar në këtë drejtim, a janë ftuar partitë opozitare apo shoqëria civile", ka thënë Demolli-Nimani. Ajo ka thënë se Kosova kohën e fundit ka marrë donacione të ndryshme nga shtete të ndryshme dhe Bashkimi Evropian dhe në këtë drejtim, siç shprehet ajo, duhet një transparencë më e madhe për mënyrën se si do të adresohen ato mjete. "Do të donim të kemi një transparencë shumë më të madhe rreth kësaj çështjeje se

si do të shpenzohen këto mjete dhe donacione nga Qeveria e Kosovës", ka thënë Demolli-Nimani.

Ndërsa Visar Xhambazi, analist nga organizata Demokracia për Zhvillim, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, me gjithë zotimet e kryeministrit Avdullah Hoti se qeveria e tij do të jetë transparente, në praktikë nuk është. Ai thotë se mostransparenca është duke u vërejtur. "Në fakt, për dallim nga qeveria e kaluar, qeveria Hoti nuk ka zëdhënësin të qeverisë. Si rezultat, kjo po krijon vështirësi për mediat për marrjen e informacioneve nga institucionet relevante. Vlen të theksohet mungesa e informacioneve në raport me dialogun Kosovë - Serbi", ka thënë Xhambazi.

Mostransparenca, ka theksuar Xhambazi, nuk është problemi i vetëm me të cilin po ballafaqohet kjo qeveri. Sipas tij, rritja e numrit të rasteve me Covid-19 si dhe mungesa e unitetit brenda koalicionit qeverisës, ka krijuar një situatë tejet të vështirë, e cila, siç thotë ai, mund ta dërgojë vendin në një krizë të re politike. "Të gjitha postet publike, të cilat i kanë këta persona, pa marrë parasysh a jemi duke folur për kryeministrin, apo ministrin apo nëpunësit civilë, të gjithë kanë përgjegjësi publike, prandaj qasja në informacione është obliguese dhe kërkohet me ligj. Në çdo moment këto institucione duhet të jenë të hapura për të gjitha vendimet që i marrin dhe, në fakt, e kanë edhe obligim ligjor t'u japin informacione mediave dhe qytetarëve të Kosovës apo të

paktën t'i publikojnë ato informacione në uebfaqet e tyre përkatëse", ka thënë Xhambazi.

Në anën tjetër, Xhavit Beqiri, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se qeveria Hoti është mjaft transparente dhe se, sipas tij, pohimet se ekzekutivi nuk është transparent, nuk qëndrojnë. "Ne me punën tonë përpiqemi që të jemi maksimalisht transparentë. Në cilësinë e këshilltarit për media, mirëpo edhe këshilltarët e tjerë të sektorëve përkatës, zakonisht u përgjigjemi interesimit të mediave. Kështu që, sa i përket Kryeministrit, në secilin aktivitet ne përpiqemi maksimalisht të jetë i hapur për opinionin dhe mediat të kenë mundësi të qasjes", ka thënë Beqiri. Ai ka shtuar se edhe sa iu përket bisedimeve dhe procesit të dialogut me Serbinë, kryeministri Hoti është transparent.

Më tutje, kryetarja e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Gentiana Begolli, ka thënë se jo vetëm qeveria Hoti, por edhe dy qeveritë e kaluara të Kosovës nuk kanë qenë sa duhet transparente. Ajo ka thënë se edhe ish-qeveritë dhe kjo aktualja kanë vonuar në emërimin e zëdhënësit të ekzekutivit. Transparenca është një çështje me të cilën merren shumë autoritete, institucione dhe biznese. Transparenca paraqet një nga parimet themelore për arritjen e një demokracie të shëndoshë dhe një shteti apo shoqërie funksionale, thonë përfaqësuesit e shoqërisë civile.

për postin e presidentit. A mund ta prishë koalicionin qeverisës ky post?

Abdullahu: Unë mendoj se para AAK-së këtë interesim, pra për ta pasur presidentin, e ka shprehur edhe LDK-ja. LDK-ja e do më shumë se cilado parti tjetër postin e presidentit. Ka kohë që kalkullohet kjo pozitë dhe për këtë punohet. Këtë nuk është e lehtë për ta kuptuar sepse, për dallim nga AAK-ja, këtë LDK-ja e kamuflon me prirjen prej një tuxharllëku që hesapet i bën, por ato nuk ia tregojnë askujt. Është marrëzi jo vetëm politike kur e mendon se sa energji po shpenzohet për këtë post, sa përçarje po ndillet për diçka që, megjithatë, nuk dihet se a fillon e si do të përfundojë dhe krejt këtë në kohë pandemie. Hile e madhe ndaj qytetarit. Ky koalicion po hyn në gjynah me qytetarin.

"Epoka e re": Në anën tjetër, as PDK-ja si parti opozitare nuk i ka fshehur ambicjet për këtë post. Pritni që partitë ta gjejnë një kompromis për këtë çështje, apo kjo do ta çojë vendin në zgjedhje të reja?

Abdullahu: PDK-ja është në opozitë dhe asaj kjo gjendje është duke i bërë mirë në shumë drejtime. Ajo ka pranuar vullnetin e qytetarëve të shprehur më 6 tetor vitin e kaluar dhe ka bërë mirë. Për këtë, guximi dhe pranimi i një realiteti të ri, si premisë për ndryshime, duhet t'i faturohet kryetarit Veseli. Edhe sikur

PDK-ja të mos bëjë asgjë, ajo, nga gabimet që po i bën qeveria Hoti dhe nga qasja përjashtuese dhe regresive që nuk po e ndryshon LV-ja, jo vetëm tërthorazi, asaj po i faturohen pikë pozitive. Këtë e kanë hetuar të gjithë, dhe të gjithë kohën e fundit janë të interesuar që të mos e lënë PDK-në në këtë pozitë opozitare. Më së shumti në këtë rast shquhen LDK-ja dhe LV-ja.

"Epoka e re": Ka mbetur pak kohë që nga takimi i Kosovës me Serbinë në Uashington. A është e gatshme Kosova për këtë takim dhe çfarë pritni nga ky takim?

Abdullahu: Është mirë që Kosova u rikthye në agjendën e Uashingtonit zyrtar nga e cila e largoi qeveria Kurti me paragjykimet e saj plot paranojë politike. Në Uashington po rifillojnë diçka që do të jetë një proces i cili nuk mund të përfundojë shpejt. Më 4 shtator në Uashington do të vihen në vija të trasha synimet dhe qëllimet e një projekti ekonomik i cili nuk mund të jetë vetëm ekonomik por, në një të ardhme të afërt, do të marrë edhe dimensionin politik. Shpresoj shumë se ato që i mungojnë qeverisë Hoti, e ato janë mangësi të shumta, do të kompensohen nga ndihma dhe përkujdesja e partnerit tonë, në këtë rast Uashingtonit zyrtar.



Komunat presin nga Qeveria lirimin e disa masave anti-Covid

PRISHTINË, 23 GUSHT - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AAK) do të takohet sot (e hënë) me kryeministrin Avdullah Hoti dhe tre ministra, ku do të diskutohet rreth kriterëve dhe formulës së shpërndarjes së 10 milionë eurove në komuna, fillimin e procesit mësimor, si dhe situatën epidemiologjike. Kështu ka bërë me dije për "Kosovapress", drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, i cili shprehet se po

në këtë takim do të lirohen edhe disa nga masat që janë ndërmarr më herët. "Në këtë takim do të diskutohen disa tema kryesore. Do të jetë fillimi i procesit mësimor 2020/21, gjithashtu do të diskutohet edhe sa i përket kriterëve dhe formulës së shpërndarjes së 10 milionë eurove në komunat e Kosovës si përkrahje në luftën ndaj parandalimit të përhapjes së Covid-19. Do të diskutohet edhe për situatën epidemiologjike në Republikën Kosovës, ku shpresojmë se disa

masa që janë ndërmarr më herët të lirohen", ka deklaruar ai. Sa i përket shpërndarjes së 10 milionë eurove në komuna, Ibrahim ka thënë se këto të fundit hyjnë në atë vijë buxhetore ku të gjitha mjetet që komunat i kanë shpenzuar në luftimin e përhapjes së Covid-19 do t'i rikthehen. "Asociacioni i Komunave të Kosovës ka kërkuar nga niveli qendror që t'ia mundësoj komunave rialokimin e mjeteve buxhetore në mënyrë që ata t'i shfrytëzojnë për

parandalimin e COVID-19. Kemi gjetur një gjuhë të përbashkët dhe kemi hapur një nën kod së bashku me ministrin e financave, ku komunave i është lejuar të shpenzojnë mjete financiare për anti-Covid dhe të gjitha ato mjete dhe ato fatura t'i adresojnë në këtë nën kod dhe pastaj niveli qendror të bëjë kthimin e mjeteve financiare komunave", ka deklaruar ai. Në takimin e 24 gushtit, do të diskutohet edhe fillimi i procesit mësimor

2020/21, për çka Ibrahim u shpreh i bindur se komunat janë të gatshme. "Komunat janë të gatshme sa i përket fillimit të procesit mësimor të këtij viti, ndarjen në grupe të caktuara apo në çfarë 'skanari' do të përdorën, do të jetë vendim individual i secilës komunë në bazë të rrethanave në teren", është ai. Ibrahim ka vlerësuar se nga fillimi i pandemisë, komunat janë treguar të suksesshme në menaxhimin e situatës epidemiologjike.



Qytetarët kërkojnë kthimin e nxënësve në shkolla, kundërshtojnë mësimin "online"

PRISHTINË, 23 GUSHT - Edhe pse ka mbetur vetëm një javë që nga fillimi i vitit shkollor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) nuk ka vendosur ende se si do të mbahet ky proces për shkak të pandemisë Covid-19. Qytetarët kanë vlerësuar se më 1 shtator fëmijët duhet të kthehen në bankat shkollore, kurse kanë kundërshtuar vazhdimin e mbajtjes së mësimin "online". Ata kanë thënë se fillimi i procesit mësimor duhet të realizohet me kapacitete të plota, pa orar të shkurtuar.

Qytetari Dilaver Kryeziu ka thënë se, pavarësisht prej situatës së krijuar me Covid-19, fëmijët duhet ta fillojnë procesin mësimor. Sipas tij, vetëm në këtë mënyrë do të ketë arsimim të mirëfilltë. "Nëse doni arsimim të dinjitetshëm, duhet të kthehen në shkolla, pa marrë parasysh se kjo është një dhimbje globale", ka thënë ai. Ndërsa Naim Bytyqi ka thënë se kthimi i nxënësve në bankat shkollore është zgjidhje adekuate. Ai ka theksuar se fillimi i procesit mësimor duhet të bëhet me kapacitete të plota, pa



orar të shkurtuar. "Shkollat duhet të hapen tamam dhe me kapacitete të plota. Normalisht jo me gjysmë orari apo me orar

të shkurtuar. Mendoj se ky është vetëm improvizim. Nëse hapen duhet të hapen tamam si duhet", ka thënë Bytyqi.

Mendim të njëjtë e të ka shprehur edhe Rifat Ejupi, i cili ka thënë se fëmijët kanë imunitet të mjaftueshëm dhe se nuk janë

të rrezikuar nga Covid. Kurse Fadil Gashi ka thënë se çështja e kthimit apo jo e fëmijëve në shkolla nuk duhet të diskutohet. Për të mësimi fitohet vetëm në këtë institucion dhe jo në platforma "online". "Nxënësit duhet të shkojnë në shkollë gjithsesi, se mësimi fitohet vetëm në shkollë. Në shtëpi është shumë keq, shumë dobët", ka thënë Gashi.

Ndërkaq Xhevat Hoxha ka thënë se kthimi në shkolla do të ishte vendim adekuat. Ai ka thënë se shumë fëmijë nuk kanë mundësi ta ndjekin mësimin "online". Në fund, Mirsad Krasniqi ka vlerësuar se fëmijët duhet të kthehen në bankat shkollore, por duke pasur kujdes të shtuar. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka paraparë fillimin e vitit të ri shkollor sipas tre skenarëve: skenari "A" përfshinë mësimin në institucionet shkollore me masat parandaluese, skenari "B" rikthimin e pjeshëm me mësim të kombinuar - prani në shkollë dhe mësim në distancë si dhe skenari "C" - mësim në distancë.

Dhjetë të vdekur dhe 111 raste të reja me Covid-19 në Kosovë

Numri i të infektuar me Covid-19 ka shënuar rënie në 24 orët e fundit në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë infektuar me virus 111 persona. Megjithatë, numri i të vdekurve në vend vazhdon të jetë i lartë, pasi që në 24 orët e fundit nga Covidi kanë humbur jetën dhjetë persona



Burrë e grua nga Rahoveci vdesin brenda dy ditësh nga koronavirusi

Gjatë të dielës një 70-vjeçar nga fshati Pataqan i Epërm i Rahovecit ka humbur betejën me koronavirusin. Dy ditë më parë nga po ky virus ka ndërruar jetë edhe bashkëshortja e të ndjerit. Këtë lajm e ka konfirmuar kryetari i Komunës së Rahovecit,

Smajl Latifi. "Gruaja ka vdekur dy dite më parë, më 21 korrik. Ka qenë 68-vjeçare. Sot ka ndërruar jetë bashkëshorti i saj 70-vjeçar. Të dy kanë qenë të konfirmuar me Covid-19. Viktimat kanë ndërruar jetë në Spitalin e Gjakovës", ka thënë Latifi.

PRISHTINË, 23 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë vdekur dhjetë persona dhe janë paraqitur 111 raste të reja me Covid-19.

Instituti ka treguar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 159 pacientë. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 448 mostra të marra nga ShSKUK, gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren dhe laboratorët privatë, prej të cilëve rezultojnë 111 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 10 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 12 448 raste nga 47 355 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 467 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 159 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 8 505 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 476", ka njoftuar IKShPK-ja.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 25 raste, komuna Pejë 13 raste, komuna Gjiilan 10 raste, komuna Gjakovë 7 raste, komuna Mitrovicë 7 raste, komuna Vushtrri 6 raste, komuna Ferizaj 5 raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Obiliq 4 raste, komuna Podujevë 4 raste, komuna Fushë Kosovë 3 raste, komuna Klinë 3 raste, komuna Rahovec 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Prizren 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog, Kamenicë, Kaçanik, Lipjan, Novobërdë dhe Shtime. Me 111 raste të reja të konfirmuara të dielën është shënuar kështu shifra më e ulët e rasteve në Kosovë që nga 17 korriku, ku ishin 103 raste të reja të infektimit.


Gjatë muajt korrik dhe muajt gusht numri i rasteve me Covid-19 ka qenë i lartë. Më 27 korrik në vend janë regjistruar 276 raste me Covid-19, numri më i madh i rasteve që nga fillimi i pandemisë.

Vazhdon të jetë i ndaluar qëndrimi përreth liqenit të Radoniqit

GJAKOVË, 23 GUSHT - Vazhdon të jenë të ndaluar larja, peshkimi dhe qëndrimi në zonat përreth liqenit të Radoniqit në Gjakovë. Lajmi është konfirmuar nga Kompania Regionale e Ujësjellësit (KRU) në Gjakovë. "Me fillimin e sezonit veror, në liqenin e Radoniqit është vërejtur fluks i madh i qytetarëve të cilët me qëllim freskimi, përkundër ndalesës nga ana e 'KRU Gjakova', me të cilën ndalohet hyrja në liqe e të gjitha automjeteve dhe qytetarëve të cilët kanë synim larjen apo aktivitete të tjera, persona të papërgjegjshëm po shfrytëzojnë hyrje të tjera përreth që të kenë qasje në liqe. 'KRU Gjakova', me synim të mbrojtjes së liqenit të Radoniqit, nga veprimet e dëmshme që ndikojnë në ndotjen dhe dëmtimin e liqenit si dhe zbatimin e kërke-

save të cilat dalin nga Ligji në fuqi në Kosovë, mbi Ujërat, Urdhëresat Administrative si dhe vendimin e Inspektoratit të MMPH-së, apelon te të gjithë qytetarët që t'i respektojnë këto ndalesa dhe të ndalën veprimet e tilla të cilat synojnë ta dëmtojnë kualitetin e ujit të liqenit si dhe në raste aksidenti, dëmtimi, apo lëndimi në njerëz, ne si institucion nuk mbajmë përgjegjësi", ka njoftuar "KRU Gjakova". Sipas këtij njoftimi, "KRU Gjakova", në bashkëpunim me Stacionin e Policisë në Gjakovë janë mobilizuar në terren për inspektimin e gjendjes së krijuar dhe ndaj personave të cilët nuk respektojnë këto ndalesa do të pasojnë dënimet e parapara sipas akteve ligjore. Ky vendim ka hyrë në fuqi që nga 30 qershori i këtij viti dhe vazhdon të jetë ende në fuqi. /KK/





Kërkohet të hiqen kushtëzimet për regjistrimin e automjeteve

Qytetarët e Kosovës për të pasur të drejtë që ta regjistrojnë automjetin e tyre janë të kushtëzuar që t'i paguajnë shpenzimet komunale dhe gjobat në trafik. Në Kosovë llogaritet të jenë të paregjistruara 148 mijë automjete, kurse vetëm në bazë të pagesave komunale me rastin e ndërrimit të pronësisë së automjeteve llogaritet që qytetarëve të Kosovës kjo do t'u kushtojë miliona euro. Këto kushtëzime janë kundërshtuar nga kryetari i Shoqatës "Konsumatori", Selatin Kaçaniku dhe kryetari i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 GUSHT - Qytetarët e Kosovës para se t'i regjistrojnë automjetet janë të detyruar që t'i paguajnë shpenzimet komunale, si pagesën e tatimit në pronë, taksën e rrugës për regjistrimin e veturave, pagesën për mbeturina si dhe gjobat e trafikut. E tëra kjo në bazë të udhëzimeve administrative të nxjerra, si ai i tatimit në pronë dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2018 për regjistrimin e mjeteve, i nxjerr nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Për ta paguar taksën rrugore, prej vitit 2011, bazuar në Udhëzimin Administrativ të tatimit në pronë, qytetarët e Kosovës duhet ta paguajnë tatimin në pronë në mënyrë që

ta kenë mundësinë ta paguajnë taksën rrugore.

Përpos pagesave komunale, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2018 për regjistrimin e mjeteve, qytetarët e Kosovës për t'i regjistruar mjetet e tyre motorike janë të obliguar që t'i shlyejnë edhe gjobat e kundërvajtjes, siç specifikohet në nenin 34, paragrafin dy të këtij udhëzimi: "Pronari i mjetit nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit me veprim motorik, as ndërrimin e pronarit, pa e bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor". Mirëpo, përkundër faktit që Avokati i Popullit ka dhënë këtë rekomandim në vitin 2018, akoma s'është marrë ndonjë iniciativë ligjore. Lidhur me këtë detyrim, në

raportin me rekomandime sipas "ex officio", rasti nr. 376/ 2008, Avokati i Popullit ka rekomanduar që të hiqet ky nen, por deri më tani nuk është bërë një gjë e tillë. "Në bazë të këtyre konstatimeve dhe në përputhje me nenin 135, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 05/ L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon që Kuvendi në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës: ta ndryshojë Ligjin Nr. 05/ L-019 për Automjete, përkatësisht ta fshijë nenin 43, paragrafin dy të tij", është thënë në rekomandimin e Avokatit të Popullit të vitit 2018. Mirëpo këto kushtëzime për shlyerje të pagesave komunale si dhe shlyerje të gjobave të

kundërvajtjes, në bazë të gjendjes së rëndë ekonomike dhe sociale, si dhe në bazë të gjendjes pandemie, janë kundërshtuar nga kryetari i Shoqatës "Konsumatori", Selatin Kaçaniku. Ai ka thënë se kushtëzime të tilla janë "zhvatje ligjore" për ta mbushur arkën e shtetit. Kaçaniku ka thënë për gazetën "Epoka e re" se detyrimi i qytetarëve të Kosovës, që t'i paguajnë obligimet komunale, para se t'i regjistrojnë automjetet e tyre, është metodë e padrejtë dhe jodemokratike. "Politika te në është e dobët dhe në vazhdimësi shikohet të gjenden mënyra me anë të të cilave i zhvatën qytetarët. Kemi thënë se është e palejueshme, jodemokratike dhe diskriminuese që konsumatorin - qytetarin taksapagues dikush ta detyrojë, e që detyrimi është zhvatje e një natyre të llojit të veçantë, pasi konsumatorët që janë gjeneruesit kryesorë të buxhetit dhe financuesit e shtetit të Kosovës në shumë forma. Nuk është faji ynë nëse shteti nuk ka mekanizma të aftë që t'i grumbullojë obligimet, prandaj është e paarsyeshme dhe joedukative që në këtë mënyrë qytetari konsumator të zhvatet",

ka thënë Kaçaniku, duke shtuar se ky kushtëzim është zhvatje tipike e autorizuar nga shteti. "Kjo është zhvatje tipike e autorizuar nga institucionet e shtetit dhe është non sens. Po të kishim forcë me siguri do ta paditnim qeverinë për këtë trajtim jo të drejtë. Politikanët dhe institucionet tona janë të paafta dhe përpiqen t'i bien trup një rruge që të çon në humnerë, prandaj duhet të ndiqet rruga e drejtë", ka deklaruar ai. Po këto kushtëzime janë kundërshtuar edhe nga kryetari i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku. Ai ka thënë se këto kushtëzime janë duke ndikuar edhe në rritjen e numrit të automjeteve të paregjistruara. Mazreku ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se i është drejtuar Avokatit të Popullit për t'i hequr kushtëzimet për regjistrim të automjeteve në mënyrë që, sipas tij, t'u lehtësohet qytetarëve barra e pagesave dhe të bie numri i automjeteve të paregjistruara. "Ne në dy vjetët e fundit si shoqatë kemi kërkuar që kushtëzimet për regjistrimin e automjeteve të hiqen. Një ndër kushtëzimet është vërtetimi për tatimin në pronë. Për të njëjtën



temë unë si drejtor kam ushtruar edhe ankesë pranë Avokatit të Popullit, ku kam argumentuar pse ky kushtëzim është kundërkushtetues dhe fillimisht kam pranuar një njoftim për provueshmërinë, pasi kur rasti ka bazë për hetim të mëtutjeshëm, avokati e lëshon një njoftim për pranueshmëri dhe besoj se shumë shpejt do të dilet me rekomandim që këto kushtëzime duhet të hiqen”, ka thënë Mazreku, duke shtuar se në sajë të këtyre kushtëzimeve në Kosovë, kemi numër të lartë të automjeteve të paregjistruara. “Kemi dhënë një statistikë, që në Kosovë janë 109 mijë automjete të paregjistruara dhe që nga atëherë ne jemi munduar të gjejmë forma sesi ta ulim këtë numër. Kemi nxjerr përfundimin, se për shkak të kushtëzimeve një pjesë e madhe e tyre nuk po i regjistrojnë automjetet, ose kanë tatim pa paguar ose kanë gjoba dhe kjo ka ndikuar në rritjen e automjeteve të siguruara. Kemi kërkuar ndryshime ligjore. Në anën tjetër, jemi ankuar tek Avokati i Popullit dhe kemi kërkuar të hiqen kushtëzimet për regjistrimin e automjeteve, siç është taksë komunale. Ky ligj është në ndryshim e sipër dhe për të u bë me dije në një takim që kishin z. Abrashi dhe Velu. Vitin e kaluar e kam dërguar edhe një kërkesë tek Avokati i Popullit. Kam kërkuar që tatimi në pronë, i cili kushtëzohet me nxjerrjen e taksës komunale, fare mos të ketë lidhje me

regjistrimin e automjeteve. Te Ligji i Automjeteve kemi kërkuar disa ndryshime që ndikojnë financiarisht në lehtësimin e procedurave, por edhe te bartja e pronësisë, që qytetarët mos të obligohen që taksat t'i paguajnë nga fillimi, dmth. taksën rrugore, taksën komunale, kontrollin teknik dhe vërtetimin komunal. Këto bartje të pronësisë u shkaktojnë qytetarëve dëme miliona euro, kurse për pjesën e sigurimit, për aq kohë sa e shfrytëzojnë është e shfrytëzueshme, kurse kur e ndërrojnë pronësinë pjesa tjetër kthehet”, ka thënë Mazreku.

Ai ka thënë se në vitin 2020 janë publikuar të dhënat për numrin e automjeteve të paregjistruara të automjeteve, që arrin në 148 mijë automjete. “Për këtë kemi mbajtur takime të shpeshta edhe me BQK-në. Vlen të përmendet se BQK-ja dhe guvernatori Fehmi Mehmeti kanë luajtur rol aktiv dhe pozitiv në këtë proces dhe me gëzon fakti që Ministria e Financave me një marrëveshje me BQK-në është zotuar se do të merret me masat dhe ndryshimet ligjore që do të ndikojnë në numrin e automjeteve të paregjistruara që më pas na lehtësojnë punën për anëtarësim në organizata jashtë Kosovës”, ka thënë ai.

Më tutje, Mazreku ka shtuar se, përveç për taksë komunale, duhet të hiqet kushtëzimi edhe për gjobat e trafikut me rastin e regjistrimit të automjeteve. “Që ky proces të jetë më i lehtë e që Ministria e Punëve të Brendshme ka vendosur një afat se deri kur duhet të regjistrohen këto automjete, do të ishte mirë që edhe MPB-ja ta pezullojë nenin ku specifikon që gjatë regjistrimit të automjeteve qytetarët duhet t'i paguajnë fillimisht gjobat e trafikut. Sigurisht që kërkesa jonë s'është që gjobat mos të paguhen, por mos të lidhen me regjistrimin e automjeteve”, ka thënë Mazreku. Edhe një qytetar nga Prishtina, Shkëmbim Krasniqi, ka kërkuar të hiqen këto kushtëzime pasi, sipas tij, gjendja ekonomike dhe sociale është e rëndë dhe qytetarëve nuk duhet t'u rëndohet edhe më tutje gjendja me kushtëzime të pagesave para regjistrimit të automjeteve. “Situata ekonomike dhe sociale është e rëndë. Të kushtëzohemi për pagesa të mbeturinave, tatimit në pronë, si dhe të gjobave me të vërtetë na vështirëson gjendjen dhe në shumë raste e bën të pamundur regjistrimin e automjeteve, shtu këtu edhe gjendjen me të cilën jemi goditur nga pandemia”, ka thënë Krasniqi.

Në takimin që ka pasur ministri i Punëve të Brendshme, Agim Velu, me atë të Infrastrukturës, Arban Abrashi, javën që lamë pas, është bërë me dije se është diskutuar për Ligjin e automjeteve, i cili është në procedurë për plotësim-ndryshim, por nuk është specifikuar se kur do të merret iniciativa për ndryshimin e këtij ligji.

70 për qind e bizneseve hoteliere punojnë me humbje

PRISHTINË, 23 GUSHT - Janë bërë gjashtë vjet qëkur Erdis Driza nga Prizreni ka shndërruar shtëpinë e vjetër të familjes në bujtinë. Punën më të madhe thotë se ka në muajin gusht, sidomos në ditët kur mbahet Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër “DokuFest”. Për shkak të pandemisë Covid-19, ky festival që ka filluar më 7 gusht dhe zgjatë deri më 25 gusht, po mbahet online. Si pasojë e kësaj, Erdis Driza ka thënë se në bujtinën e tij që mund të flenë brenda natës deri në 17 persona, tash nuk është askush. Ai ka theksuar për “Radion Evropa e Lirë” se do ta mbyllë bujtinën e tij, biznes ky me të cilin ai mban familjen pesanëtarëshe. “Në mars sa deshëm ta hapim, pas një rinovimi të vogël, filloi izolimi dhe e mbyllëm dhe prej atëherë, që pesë muaj, diku 15 mysafirë i kemi pasur. Këtë javë më duhet të shkoj në ATK që ta paraqes mbylljen e bujtinës sepse është tremujori i dytë që po më duhet ta paguaj Trustin, tatimin, të gjitha po më duhet t'i paguaj, e në anën tjetër nuk po bëjmë aq para sa të paguajmë ato që janë obliguese”, ka thënë Driza.

Të papunë janë edhe kompanitë turistike në qytetin perëndimor të Kosovës. Mentor Bojku nga Peja është bashkëpronar i



kompanisë “Outdoor Kosovo”. Ka disa vjet që me veturat e kompanisë ai dhe punëtorë të tjerë kanë bartur dhjetëra turistë brenda ditës për në bjeshkët e Rugovës dhe në lokacione të tjera, mirëpo që nga fillimi i pandemisë veturat e tij kanë mbetur të parkuara dhe të pashfrytëzuara si pasojë e mungesës së vizitorëve. Bojku ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se aktualisht nuk e kanë të angazhuar asnjë punëtor dhe janë duke punuar vetëm ai dhe partneri i tij në biznes. “Gjatë kohës kur nuk ka sezon jemi të angazhuar dy-tre persona, ndërsa kur është vrulli i punës, mbërrin deri në 15-16 punëtorë. E njëjta periudhë e këtij viti, krahasuar me vitin e kaluar, jemi të angazhuar vetëm dy persona sa për të mos u mbyllur firma”, ka thënë Bojku.

Për çdo vit Kosovën e vizitojnë

miliona turistë. Një vizitë dyditore në Kosovë një turisti i kushton nga 100 deri 150 euro. Sipas shoqatave të turizmit në Kosovë, rënia e numrit të turistëve ka bërë që të ketë deficit deri në 20 milionë euro në këtë sektor. Baki Hoti, kryetar i Unionit të Turizmit të Kosovës, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se sektori i turizmit është në një kolaps total. Ai ka thënë se rimëkëmbja e këtij sektori do të jetë e vështirë pasi kërkon një kohë më të gjatë. Sipas kryetarit të Odës së Hotelierisë dhe Turizmit, Hysen Sogojeva, 70 për qind e bizneseve të hotelierisë janë duke punuar me humbje. “Duke ditur natyrën e punës që e ka hotelieria, numri më i madh i punëtorëve është në sektorin e turizmit dhe hotelierisë dhe si rezultat i kësaj, edhe masat të cilat janë ndërmarrë në fillim, ky sektor ka qenë më i atakuari”, ka thënë Sogojeva.

Thaçi: Jemi të bekuar me bereqetin e tokës sonë

Prishtinë, 23 gusht (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se janë të bekuar me bereqetin e tokës sonë. Ai ka thënë se vreshtat e Rahovecit janë të mrekullueshme falë punës dhe bujqve të kësaj ane. “Jemi të bekuar me bereqetin e tokës sonë. Këto vreshta në Rahovec, të mrekullueshme i kanë bërë puna, djersa dhe munda i bujqve tanë”, ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në “Facebook”. Thaçi në vazhdimësi është duke publikuar në rrjetet sociale imazhe nga bujqësia, kultura dhe infrastruktura.



Mustafa: Brenda mundësive do t'i kompensojmë dëmet e breshrit



PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka vizituar sot fermerët e fshatit Drenoc të Komunës së Prishtinës, të cilët janë prekur nga dëmet e breshrit dhe reshjet e fundit të shiut. Në profilin e vet në “Facebook”, Mustafa ka shkruar se brenda mundësive buxhetore të ministrisë do të angazhohet që t'i kompensojnë

këto dëme të bujqve. “Sot gjatë ditës vizitova fermerët e fshatit Drenoc të Komunës së Prishtinës për t'i parë nga afër dëmet e shkaktuara nga shiu dhe breshëri. Brenda mundësive buxhetore të ministrisë do të angazhohem që t'i kompensojmë këto dëme të bujqve, duke u bazuar në raportet e përpiluara nga komisionet komunale”, ka shkruar Mustafa.

Haziri: Respektimi i masave, e vetmja mënyrë e parandalimit të përhapjes së Covidit

GJILAN, 23 GUSHT (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të Gjilanit, Lutfi Haziri, është mbajtur mbledhja e Komitetit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. Në takim është bërë me dije se deri tani 750 qytetarë të Gjilanit kanë rezultuar pozitivë me Covid-19, prej tyre 529 janë shëruar, 191 janë raste aktive, 59 janë të hospitalizuar dhe 30 kanë vdekur. Me këtë rast, Haziri u

ka bërë thirrje qytetarëve dhe bizneseve që t'i respektojnë masat anti-Covid si e vetmja mënyrë për ta parandaluar përhapjen e këtij virusi. "Apeloj që t'i respektoni masat mbrojtëse, maskat, distancën sociale dhe mbajtjen e higjienës kundër virusit të panjohur. Virusi nuk pyet çka e kush je. Të rrëzon përtokë e të merr me vete nëse nuk ruhesh!", ka thënë Haziri.



Në Llapçevë fillon asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i ndriçimit publik

MALISHEVË, 23 GUSHT (ER) - Në fshatin Llapçevë të Malishevës ka filluar asfaltimi i 1 200 metrave rrugë brenda fshatit si dhe ka nisur rregullimi i ndriçimit publik. Këto punime i kanë inspektuar drejtori i Urbanizimit, Ahmet Morina dhe shefi i prokurimit, Nuhi Shala, të cilët janë pritur nga kryetari i fshatit, Hazir Avdiaj dhe banorë të tjerë të Llapçevës. Gjatë vizitës në

Llapçevë drejtori Morina ka thënë se moto e këtyre investimeve që janë duke u bërë në Komunën e Malishevës është "Malisheva e re". "Kemi filluar rregullimin e ndriçimit publik në sheshin dhe në disa rrugë të Llapçevës, si dhe kemi filluar asfaltimin e 1 200 metrave rrugë brenda lagjeve të fshatit. Me këto investime gradualisht po përmbushen nevojat e banorëve dhe investimet për

infrastrukturën e fshatit", ka thënë Morina, duke shtuar se qeveria Begaj është përkushtuar për realizimin e shumë projekteve në infrastrukturën e përgjithshme. Ndërsa kryetari i fshatit Llapçevë, Hazir Avdiaj, e ka falënderuar Komunën e Malishevës dhe kryetarin Ragip Begaj për realizimin e këtyre projekteve shumë domethënëse për banorët e këtij fshati.

Nis rregullimi i kompleksit memorial në Korishë të Prizrenit

PRIZREN, 23 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtori i Drejtorisë së Administratës, Osman Hajdari, kanë bërë përrurimin e rifillimit të punimeve të kompleksit memorial në Korishë, i cili u dedikohet vik-

timave të luftës së fundit. "Ky projekt do të përfundojë sipas planit dinamik dhe do të jetë një ndër komplekset kryesore që do të dëshmojë për sakrificën e martirëve dhe krimet e ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Sot rifillon punën çerdhja 'Gëzimi Ynë' në Mitrovicë

Mitrovicë, 23 gusht (ER) - Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë ka treguar se janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për rihapjen e institucionit parashkollor publik "Gëzimi Ynë". Drejtori i kësaj drejtorie, Egzon Jashari, ka takuar personelin e çerdhës publike "Gëzimi Ynë", me të cilin bashkërisht kanë bërë me dije se nga sot (e hënë) do të rifillojë punën për edukimin e fëmijëve të grup moshave 0-3 dhe të atyre 3-6. "Duke analizuar situatën nëpër të cilën po kalojmë dhe përballë nevojave për rifunksionim të institucioneve parashkollore, kemi punuar intensivisht së bashku që të përgatitemi sa më mirë, që

fëmijëve tani t'u ofrojmë ambient të sigurt sipas rekomandimeve të institucioneve shëndetësore. Nga e hëna, në çerdhën publike veprimet tona do të jenë në përputhshmëri me protokollet e veprimit të cilat specifikojnë ecurinë e punës tonë përballë situatës pandemike e cila po na sfidon tash e sa muaj", ka thënë Jashari. Në këtë takim është diskutuar nga të pranishmit edhe zbatimi i protokolleve të veprimit, konkretisht organizimi i brendshëm i çerdhës, hallka e komunikimit prind-fëmijë-educatore si dhe veprimet konkrete përballë rasteve potenciale me Covid-19.



USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS KA SJELLË VETËM LAVDI (34)



Shkruan: Kudusi LAMA

Njëkohësisht, meqë ju e keni përsëritur shumë herë “luftën e përgjakshme midis grupazheve të UÇK-së”, edhe mua më lind e drejta ta përsëris aq herë se UÇK-ja ka qenë një dhe nuk ka pasur grupazhe, nuk ka pasur fraksione siç i quani ju, nuk ka pasur konflikte, por ka pasur një strukturë unike me hierarki e disiplinë të plotë prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së e deri tek ushtari i fundit. Duhet të mos tentoni të mashtroheni edhe në fushën e organizimit ushtarak, mjaft keni mashtuar politikisht ju dhe ata si ju, gjatë luftës çlirimtare edhe sot. Duhet të dini njëherë e mirë se askush për askënd nuk ka nevojë të fshehtë krime. Sepse Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka sjellë vetëm lavdi në këtë komb. Nëse dikush ka bërë krime personale, siç ndodh edhe te ju në Evropë, le të japë llogari para ligjit, por mos ngatërroni me fjalë luftën e lavdishme të shqiptarëve për lirinë e dëshiruar e të arritur, pavarësisht nëse e shikoni me sy të mirë ju ose jo.

Si edhe në mjaft pika të tjera të këtij raportit edhe në pikën 14, ju prapë pretendoni se “*Bashkëpunimi midis instancave të ndryshme ndërkombëtare dhe autoriteteve kosovare, si dhe i autoriteteve kompetente të Shqipërisë për të zbardhur fatin e personave të zhdukur për të dëshiruar*”. Por unë nuk di kë konsideroni bashkëpunim ju. Ndoshta vetëm pranimin e gjithçkaje që pretendoni ju, sipas shënimeve që iu kanë dhënë të gatshme serbët. Sepse gjithnjë sipas jush, Serbia është për të marrë shembull, pasi ka pranuar të hapë gropat e groposjes së mijëra shqiptarëve të masakruar. Sa lavdi paska Serbia për këtë që bën. Po pse ç’mendonin ju se mund të bënte Serbia ndryshe? Pse flisni në përgjithësi e nuk thoni emra, kush iu pengoj në Kosovë e në Shqipëri, pasi unë në media, kam dëgjuar gjithnjë nga autoritetet e të dy shteteve shqiptare të thuhet se është gatishmëri e plotë të kërkohet e të gjendet gjithçka që pretendohet? Por ju kështu do të thoni për të justifikuar dështimin, pasi nuk mund të thoni se nuk kishte gjë. Ju doni

ta lini hijen e dyshimit të pranishme, se kështu i jepni goditjen që keni marrë detyrë t’ia jepni kombit shqiptar.

Ju zotëri Marty jeni treguar vërtet artist për ngritjen në sytë e gjithë botës, të të keqes që imagjinoni se mund të ketë ndodhur, ose improvizoni si të ndodhur. Jeni vërtetë i habitshëm për sigurinë me të cilin e reklamoni mashtrimin. Për t’u bindur le të shikojmë pikën 16 të raportit tuaj. Ku ju duke iu referuar asaj “shtëpisë së verdhë”, që pretendoni se ajo është vetëm maja e ajsbergut që do të zbuloni ju, sepse ajo është vetëm një çështje e dorës së dytë. Pra ju duke u nisur nga një “fakt”, nxirrni konkluzione të gjerësisë së problemit. Dhe pasi zini në gojë shumë herë shkencën dhe punën shkencore, sikur ju jeni eksperti i kësaj fushe, nuk thoni se pse nuk bëtë ekspertizën e duhur kur edhe ju pranuan të shikoni shtëpinë. Po kështu iu bën përshtypje, që nëpërmjet verifikimeve, keni parë njollat e gjakut. Së pari, sa qëndrojnë njollat e gjakut pa u shpërbërë? Nëse ekzistojnë a mund të gjendet se i kujt është ky gjak? Me sa di unë sipas atyre që kam lexuar dhe informacioneve që jepen ka mundësi. Njëkohësisht, dua të pyes a keni parë ndonjëherë në fshat se ruhen bagëti dhe ata edhe theren për nevojat të familjes? Ashtu sikurse kam dëshirë t’iu pyes, ju andej nga vini a nuk i pastroni shtëpitë nga gjaku kur therni bagëti dhe kur ju lindin gratë? Ne këtej i pastrojmë. Por ju keni bërë lojëra me fshatarin, i cili pa hile iu ka thënë se kjo është shtëpi ku ka jetë, theren bagëti e edhe lindin gratë. Prandaj mos bëni shaka me ndershmërinë e fshatarit tonë. Njëkohësisht, dua të pyes, a vërtetë mendoni se po të kishte pasur operacione e heqje organesh jetike njerëzore në atë shtëpi, do të mbetej ashtu e pa prekur që të vinit e ta shikonit dhe ekzaminonit ju? Sa interesant jeni zotëri, por çudi sa sukses keni pasur me mashtrimin artistik që keni bërë në gjithë botën.

Zotëri, unë po ju them me sigurinë më të plotë, se po të ishte therur njeri në atë shtëpi, kryetari i familjes do ta kishte marrë familjen dhe do të kishte ikur nga sytë këmbët. Ne nuk jetojmë dot me kufoma në këmbë. Nuk e kemi zakon dhe nuk e pranon logjika shqiptare. Ne edhe kur bëjmë shtëpi të re, kërkojmë të gjejmë vendin më të pastër, ku të mos ketë pasur mundësi asnjëherë për të varrosur njeri. Më duket se na keni ngatërruar me të dashurit

tuaj, serbët, të cilët, siç po del aktualisht, mbi gropat e groposjes masive të shqiptarëve paskan bërë edhe shtëpitë ku jetojnë. Mos mendoni se kemi të njëjtën mendësi, jemi shumë larg në këtë pikëpamje, çfarë shikoni tek serbët, mosmendonise duhet të ndodh edhe ndër shqiptarët. Por nuk keni faj, se loja kjo është, ashtu iu kanë thënë ata, ashtu shkruani ju, e ata zotëri nuk konceptojnë më përtej se ato që i bëjnë vetë. Mendojnë se çfarë bëjnë vetë e bëjnë edhe të tjerët.

Shumë interesant zotëri, megjithëse keni shumë ide, shumë fakte, shumë njohuri, shumë parashtrime, shumë parashikime, shumë paramendime, gjithnjë iu shkatërrohen provat. Dhe ato ua shkatërrojnë edhe hetuesit shqiptar, edhe prokuroria shqiptare, por edhe Gjykata ndërkombëtare për krime lufte në Hagë, kryeprokurori i kësaj gjykate, e ndoshta shumëkush kuptohet, se pa angazhim maksimal ndërkombëtarë, fakte që arkivohen në gjithë Evropën nuk mund të zhduken lehtë. Dhe megjithëse i vetëm arrini të bindni Këshillin e Evropës, që siç vlerësoj unë paska qenë i parapërgatitur për këtë bindje, por duhej vetëm një shkresë si kjo juaja, që quhet raport. Jeni shumë i fuqishëm, jeni për t’u simpatizuar, një përballë të gjithëve dhe fitimtar, megjithëse me prova të “prishura” ndërkombëtarisht. Këtë thotë pika 17 e shkresës, më fal për ngatërruesen, raportit tuaj.

Realisht ju nuk keni faj. Faj kam unë që lexoj raportin tuaj. Faj kanë bashkëkombësit e mi që të kanë lënë të shkelësh në tokën tonë, sikur të kishte edhe status nga Perëndia, jo vetëm nga Evropa, faj ka Këshilli i Evropës, që të dërgon tek ne, dhe pastaj lexon e miraton edhe shkresën tënde. Sepse në pikën 18, të kësaj shkrese, (raporti), t’i tregon vetë që je bashkëpunëtor i serbëve e punon për Serbinë e ne të marrim seriozisht. Po si more edhe “*Prokurorit të posaçëm për krimet e luftës në Beograd, që ka bërë përpjekje të konsiderueshme, nuk arriti as ai në rezultate shumë konkrete*”? Ia prishën punën mediet. Çudi, mediat ia prishën punën atij por ta ndreqën punën ty, që të bësh një raport vërtetë të suksesshëm për Këshillin e Evropës. Bën mirë që në shkresë, (raport) e falënderon “prokurorin e posaçëm për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e tij”, ai ka

vlera dhe merita, e pranoi edhe unë, pasi është jo vetëm shefi yt, por edhe ai që të ka përgatitur shkresën (raportin). Në pikën 19, vlerësoni se ekipi i prokurorëve dhe i hetuesve “*ndërkombëtarë në gjirin e misionit të EULEX-it, i ngarkuar për të hetuar lidhur me pohimet për trajtime çnjerëzore, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me një trafikim të mundshëm organesh, ka bërë përparime konkretisht për sa i përket provës së ekzistencës së vendeve të fshehta të burgimit të UÇK-së në Veri të Shqipërisë*”, deri këtu mirë, ndoshta edhe ata kanë bërë një punë. Por konkluzioni juaj që “vërteton” diçka të pa provuar prej tyre, më habit, pasi ju vazhdoni fjalinë duke deklaruar si të ishit vëzhgues perëndie “*ku do jenë kryer edhe vrasje*”. Nga e nxirrni këtë zotëri? Apo edhe këtu e keni gjetur zgjidhjen. Ju kanë penguar autoritetet shqiptare, që nuk kanë pranuar atë që doni ju. Interesant, si nuk iu vjen pak turp për atë që deklaroni në emër të Evropës. Në pikën 20, jeni marrë me klinikën Medikus, për të cilën mund të flisni si të doni, pasi mua nuk më zgjon asnjë interes. Ata që kanë vepruar le të sqarojnë pozicionin e tyre. Po pse duhet të ketë lidhje me UÇK-në dhe luftën e saj, këtë nuk e kuptoj, pasi më duket se abuzoni me një tog fjalësh pa kuptim, bile duke akuzuar se nuk iu kanë ndihmuar edhe Gjermania, Bjellorusia, Federata e Rusisë, Izraeli, Moldavia, Polonia dhe Turqia. Shumë kundërshtarë keni zotëri, që ju pengojnë të deklaroni kriminelë shqiptarët, e megjithatë arrini të bëni një raport të pranuar nga Këshilli i Evropës.

Zotëri, ju duhet të jeni i bindur se të marrësh nën hetim 1, 10, 100 apo 1000 luftëtarë të UÇK-së, nuk e njollos dot portretin e saj. Me makinacionet që përpiqeni të koordinoni mund edhe të akuzoni dikë, por duhet të jeni të sigurt se në fund ju do të dështoni dhe do të mbeteni si figura më banale në historinë e kombit shqiptar. Koha do ta vërtetojë këtë që po të them. Rrofsh dhe e përjetofsh këtë në jetën tënde.

Në pikën 25 i referoheni nderit shqiptar. Nuk di çfarë vlere ka nderi andej nga vini ju, ndërsa për shqiptarët është elementi i ekuilibrit kombëtar. Por nderi për shqiptarët kërkon të mos mashtrojmë, të mos shpifim, të mos i ngarkojmë barrë askujt pa qenë të sigurt, të mos ndjejmë kënaqësi duke

improvizuar fatkeqësi për të tjerët, të mos marrim atë që nuk na takon, të mos deklarojmë atë që nuk e kemi parë me sy apo e kemi ndjerë me veshë, të mos përfitojmë duke ngarkuar të tjerët, të mos hamë bukën e huaj për të dëmtuar vendin tonë, të mos biem nën presion të askujt dhe për asnjë arsye për të thënë të pavërteta, të deklarojmë publikisht gjithnjë të vërtetën pa u trembur prej askujt, të ndihmojmë atë që nuk ka mundësi, të respektojmë të vdekurit pavarësisht nga origjina ose etnia e tyre, të duam e ndihmojmë fëmijët, të ndihmojmë pleqtë dhe të pamundurit, etj. Nëse i kuptoni këto, duhet të merrni vesh njëherë e mirë se me shqiptarët duhet folur vetëm sinqerisht, po të doni të mirëkuptoheni me ta. Shqiptarët nuk mashtrohen me shpërblime e mjete nuk di për cilat e keni fjalën kur thoni se nuk ishit aq i fuqishëm me mbështetje për të gjetur dëshmitarë. Ndër shqiptarët dëshmitarë për të vërtetën mund të gjeni gjithë popullin pa përjashtime, ndërsa për mashtrome nuk do të gjeni asnjë kurrë.

Zotëri, ju siç duket çfarë keni lexuar për shëmtitë e kësaj bote keni marrë përsipër t’ua vishni shqiptarëve. Ju arrini deri atje sa zbuloni edhe “mafian shqiptare” në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni por edhe në diasporën e respektuar shqiptare, që qenka më e fuqishme se “mafia italiane”, sepse ju megjithëse e zbuloni, nuk arrini të depërtoni në të. Jeni shumë interesant zotëri, që pa asnjë fakt nxirrni konkluzione dhe të gjitha konkluzionet tuaja përputhen plotësisht me shpifjet serbe për shqiptarët. Por ju jeni shqetësuar shumë, që nuk keni gjetur as në nivelet më të ulëta të hierarkisë së kësaj “mafie”, dëshmitarë që më mirë do të “parapëlqenin të qëndronin dhjetëra vite në burg apo të dënoheshin goftë edhe për pengesë drejtësie, sesa të dorëzonin një anëtar të klanit të tyre”, siç shpreheni në pikën 26 të raportit tuaj. Por ajo që nuk kuptoni ju është e vërteta, se shqiptarët nuk e njohin termin “klan”, të cilin e përdorni ju sipas literaturave mafioze që keni lexuar. A e keni lexuar historinë e “Ku Klus Klanit”? Atje i keni marrë këto konkluzione? Kuptoni mirë, se shqiptarët nuk tremben nga askush, në këtë tokë. Shqiptarët përpiqen t’i nderojnë të gjithë, por jo të bëhen vegla të të tjerëve. (Vijon)

Menaxhimi i artit në kushtet e pandemisë



Nga shumë studiues konkludohet se menaxhimi i artit shërben si një zgjidhje për problemet sociale të shoqërisë. Ka nevojë për një vizion alternativ dhe plotësues që lejon, vlerëson dhe promovon perspektiva të tjera të vlerave krijuese në menaxhimin e artit.

Përvoja e shumë shteteve vërteton se komunitete të tëra mund të mbështeten vetëm mbi identitetin kulturor të tyre, si një burim të vlerave krijuese. Sidoqoftë, në shumicën e këtyre përvojave kontributet sociale që janë prodhuar nëpërmjet proceseve menaxhuese spontane dhe intuitive, janë të një rëndësie shumë të madhe dhe me impakt për komunitetet respektive. Këto procese, në të cilat është krijuar një vlerë sociale, drejtojnë në shumë raste në një parakusht për krijimin e një vlere ekonomike.

Por, çfarë është menaxhimi artistik dhe një menaxher arti?

Përkufizimet për këtë funksion janë të ndryshme, sipas studiuesve të ndryshëm. Menaxhimi artistik është një fushë që lidhet me operacionet e biznesit të një subjekti artistik. Si rrjedhojë, menaxherët e artit janë përgjegjës për lehtësimin e operacioneve të përditshme të subjektit artistik dhe plotësimin e misionit të tij.

Termi “subjekte artistike” përfshin entitete profesionistësh jofitimprurëse (teatër, muzeume, orkestra simfonike, organizata muzikore (xhazi etj.), teatër operash, kompani baleti etj.), si dhe shumë subjekte fitimprurëse të lidhura me artin (p.sh. shtëpitë e ankandeve, galeritë e arteve, kompani

muzikore, teatro etj.). Në këto fusha, përgjegjësitë e një menaxheri të artit mund të përfshijnë menaxhimin e stafit, aspekte të marketingut, menaxhimin e buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet), marrëdhëniet me publikun, gjetjen e fondeve, zhvillimin dhe vlerësimin e projekteve të ndryshme, si dhe përgatitjen e relacioneve për bordet drejtuese të këtyre subjekteve. Paragrafi i mësipërm paraqet fushën e gjerë të aktivitetit, por dhe shkallën e lartë të profesionalizmit që nevojitet për një menaxher arti. Fushat e menaxhimit të artit janë të shumëllojshme, që nga artet pamore (figurative), muzika, aktrimi (teatri), filmi, etj. Duke ju rikthyer funksioneve të menaxherit të artit, duhen nënvizuar pikërisht elemente të tillë si:

- **Vlerësimi i artistit, transformimi e fuqizimi tij në një brand (markë);**
- **Konceptimi, hartimi dhe zbatimi i strategjisë së veprimtarisë së artistit;**
- **Ideimi i planit të komunikimit marketing, duke e përshtatur me rrethanat dhe kushtet;**
- **Hartimi i planit të biznesit të sipërmarrjes artistike dhe ndjekja e zbatimit të tij;**
- **Marrëdhëniet e punës, si dhe marrëdhëniet me strukturat shtetërore.**

Të gjitha këto elemente kërkojnë një trajtim të saktë profesional dhe menaxherial, kërkojnë bashkëpunim të ngushtë ndërmjet dy “palëve” artist-menaxher, të cilët i bashkon qëllimi i përbashkët për maksimizimin e vlerave artistike dhe për rrjedhojë edhe financiare të artistit apo institucionit artistik.

Efektet e pandemisë botërore

ndjehen në çdo vend dhe në çdo fushë të aktivitetit njerëzor. Kjo ndjehet e dhe në fushën e artit, ku interesi për të investuar në arte e objekte të koleksionueshëm, ka rënë në mënyrë drastike. Po japim shembullin real të tri shtëpive të mëdha të ankandeve Christie’s, Sotheby’s dhe Philips. Rezultoni që në tremujorin e dytë të vitit 2020, të ardhurat nga shitja e objekteve të artit dhe të koleksionizmit në tërësi, ranë me rreth 80 për qind, ose në shifra nga 4,4 miliardë dollarë në tremujorin e dytë të 2019, në të njëjtën periudhë të vitit 2020, shitjet ishin për më pak se një miliard dollarë. Kjo ulje e shitjeve është më e madhe se ajo e vërtetuar gjatë krizës së vitit 2008-2009, kur të ardhurat e ankandeve në tremujorin e dytë të 2008 ishin 4,8 miliardë, ndërsa në tremujorin e dytë të 2009 ato u ulën në 1,6 miliardë dollarë.

E njëjta histori për artistët e skenës dhe të ekranit. Aktivitetet muzikore pothuaj janë mbyllur në të gjithë botën. Armata e këngëtarëve, muzikantëve, aktorëve, janë në kërkim të alternative të reja. Shumë artistë gjatë kësaj periudhe, dhanë shembullin e tyre për të lehtësuar “lockdown-in” në një shumicë vendesh në botë. Vërtet artistët nuk përfituan financiarisht nga performancat e tyre në kushtet e pandemisë, por ofruan një shembull pozitiv dhe i dhanë shpresë publikut, duke përmbushur funksionin e artit.

Në fushën e artit figurativ u bënë shumë ekspozita online vizuale, që më pas u kalua në hapjen e muzeumeve dhe galerive në mbarë botën. Në 7 korrik 2020, një nga muzeumet

më të njohura të Turqisë, Pera Museum, hapi dyert pas katër muaj mbylljeje. Dyert u hapën me ekspozitën “Constructing a dream”- me artistët shqiptarë me vepra të periudhës së realizmit socialist. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri në 15 nëntor. Gjithë media elektronike dhe e shkruar turke, por dhe e huaj kanë përcjellë me entuziazëm këtë aktivitet.

Ndërsa, muzeumet e famshme të Uashingtonit, Nju-Jorkut, Vjenës etj. kanë gjetur forma origjinale për të përhapur artin dhe kjo nëpërmjet prodhimit të maskave të fytyrës (që po përdoren gjerësisht sot), me pikturat e Van Gogh-ut, Gustav Klimt-it, Andy Warhol-it etj.

Alternativa të reja po shfaqen, veçanërisht duke shfrytëzuar zhvillimet e teknologjisë së informacionit, këtu duket dhe do të duket kreativiteti i artistëve, por dhe menaxherëve të tyre, për të tejkaluar situatën e krijuar. Shtetet (qeveritë) në përgjithësi kanë qëndruar indiferente ndaj artistëve. Pak, për të mos thënë asnjë ndihmë, asnjë përkrahje.

Në Shqipëri, në periudhën mars-qershor 2020, shteti përgjithësisht qëndroi indiferent ndaj artit dhe artistëve. Artistët, veçanërisht këngëtarët protestuan. Mbyllja e aktivitetit të tyre (ndalimi i koncerteve me pjesëmarrjen e publikut) bën që të ketë ndikime negative financiare për ta dhe familjet e tyre. Ndryshe po ndodh me artin pamor (figurativ). Duke filluar nga qershori, në Tiranë, Fier, Vlorë janë hapur disa ekspozita, ku vlen të përmenden Ekspozita e Vizatimit Shqiptar para dhe pas 1990-tës (kurator H. Haliti), Personalen e Abaz

Hados “Fituam jetën” (krijimtari e realizuar nga ky autor i talentuar gjatë ditëve të izolimit prej pandemisë), të dyja këto të hapura në Muzeun Historik Kombëtar, Ekspozita me temë detin “Visto Mare”, hapur në galerinë Promenade të Vlorës (kurator A. Shabani), etj.

Por, të bie në sy indiferentizmi i Galerisë Kombëtare të Arteve (që do të quhet Muzeu Kombëtar i Artit) – asnjë aktivitet. Duke u rikthyer tek muzika, përpjekje me sinjifikative mund të ishin bërë nga teatri i Operës, Orkestra Simfonike e RTSh-së, e të tjera institucione artistike publike, ku janë të angazhuar dhjetra krijues të talentuar, që duhet të kishin improvizuar dhe realizuar projekte të tëra muzikore dhe në kushtet e pandemisë.

Mungoi dhe po mungon pothuaj tërësisht në këtë situatë, roli i menaxherit të subjekteve artistike. Nëse në fushën e artit figurativ ka disa përpjekje që i përmendëm (për hir të vërtetës kanë patur mbështetje nga Ministria e Kulturës. Bashkia e Tiranës, Bashkia e Fierit, etj.), në fushat e tjera të artit ka pak aktivitet, ndoshta për shkak dhe të sezonit veror në të cilin ndodhemi.

Gjithmonë kujtojmë thënien e një prej këngëtarëve më të njohur të muzikës pop në Ballkan, i cili është shprehur se me aktivitetin e tij artistik merreshin dy menaxherë, të cilët organizonin gjithçka. Ndërsa këngëtarin informohej për çdo detaj dhe merrej vetëm me koncertin, procese këto që lehtësonin aktivitetin artistik të këngëtarit. Prania e menaxherit të artit pranë artistit, apo institucionit artistik është një kosto për ta, që mund të shkojë në shumë raste 10, 20, apo 35 për qind e të ardhurave të realizuara, por përfitimet financiare nga prania e një menaxheri profesionist në shumë raste e tejkalojnë këtë “pengesë”, apo tarifë, si shpenzim i arsyeshëm i artistit ndaj menaxherit.

Në këtë situatë, ku perspektiva e kthimit në jetë normale nuk është e qartë, është koha që dhe në fushën e artit të përgatiten e të trajnohen menaxherët e ardhshëm, të cilët, përveç të tjerash do të ndikojnë dhe në rritjen e cilësisë artistike. Pra, roli i këtij profesioni të rëndësishëm, që ka ndikimin e vet në jetën shpirtërore të publikut në tërësi, në këtë periudhë pandemie, është tepër vendimtar dhe udhërrëfyes për artistët dhe publikun, në gjetjen e formave dhe rrugëve të reja, që mund të japin efekte pozitive reciproke për ta. /empower.al/





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E jashtëzakonshme

Një ari rrëmben ushqim nga një dyqan

Ariu ka "vizituar" një dyqan ushqimesh në Kaliforni, derisa ka rrëmbyer ushqim, pastaj është dukur ta hajë atë afër një kutie plehrash. Një grua duke ndaluar afër dyqanit të ushqimeve ka kapur çastin interesant, kur një ari i madh ishte ndaluar duke kapur një qese me ushqim. Ajo e ka publikuar këtë ngjarje në llogarinë e vet në "Facebook", duke e ndarë me të tjerët.



BARSOLETA E DITËS



Genci: A po ma blenë një byrek?
Beni: Po, me kënaqësi.
Genci: Jo, mos ma merr me kënaqësi, por me djathë.




Në Kino ABC nuk ka shfaqje

FOTO E DITES



Deti me dallgë nuk ndal pushuesit në Malin e Robit. /LSA/



E rrallë

Lind një viç mutant me dy koka

Një viç ka lindur me dy koka dhe ka habitur njerëzit në lagjen lokale në Kinën juglindore. Halla Zhang ka thënë se lindja ka zgjatur shtatë orë dhe se kafsha nuk ishte në gjendje të ngrihej më vete, por mund të pinte qumësht nga të dyja gojë. Viçi i pazakontë ka tërhequr vëmendjen e shumë

banorëve të fshatit, të cilët janë mbledhur në shtëpinë e hallës Zhang për ta parë atë. Një fqinj i saj u ka thënë gazetarëve se kishte ardhur për ta parë kafshën sepse nuk mund t'i besonte lajmet. Besohet se viçi ishte prekur nga një mutacion gjenetik, ndërsa ishte ende brenda mitrës së nënës së saj.

 <p>DASHI Do ta rikuperoni entuziazmin që prej kohësh ju ka munguar. Mos e refuzoni mundësinë e bërjes së ndryshimeve në një situatë dekilate.</p>	 <p>DEMI Ndihehi i mbyllur, i dyshimtë dhe i hutuar. Ju jeni një person shumë i dashur me të gjithë, mirëpo kujdes, pasi jo të gjithë e meritojnë dashurinë tuaj.</p>	 <p>BINJAKËT Tani ju ndieni nevojën për t'i ndryshuar disa nga zakonet tuaja, madje edhe ato të një kohe të gjatë.</p>	 <p>GAFORRJA Është vërtet një kohë e mirë për ju! Siç e kuptoni, kushtet për sukses janë, thjesht azhurnoni njohuritë tuaja dhe mos kini frikë të merrni rreziqe.</p>	 <p>LUANI Do të jeni përballë një ngjarje të papritur, qartësia dështon dhe ju do ta humbni ekuilibrin tuaj. Aq shumë saqë në fund ajo që ishte një gur do të bëhet mal!</p>	 <p>VIRGJËRESHA Të mbështetur nga Hëna dhe Akrepi ju do të jeni super i kënaqur. Kudo që të jeni, çfarëdo që të bëni do të jeni objekt i vëmendjes.</p>
 <p>PESHORJA Do të jeni afër familjarëve tuaj dhe një darkë e paharueshme me shumë njerëz do të ta plotësojë ditën.</p>	 <p>AKREPI Vullneti për të jetuar nuk do të mendojë dhe ju mund t'i ndani me miqtë tuaj të zemrës të gjitha çastet e bukura.</p>	 <p>SHIGJETARI Ndjeshmëria duket se është tërhequr dhe dashuria nuk ka asgjë për t'ju thënë. Vetëm imagjinata ju ka mbetur për të shkuar në det.</p>	 <p>BRICJAPI Ju keni disa njerëz që punojnë për ju dhe do të keni një sukses të porsosur në projektet tuaja. Vazhdoni t'i llogaritni të gjitha mundësitë.</p>	 <p>UJORI Nuk ka rreziqe serioze dhe ju mund të përballeni me lajmet duke besuar se gjithçka do të jetë mirë megjithatë.</p>	 <p>PESHQIT Nëse jeni duke shkuar për një udhëtim, mos harroni të shtoni një send elegant në valixhen tuaj.</p>

Morena Taraku provokon me fotot në bikini

Morena Taraku konsiderohet një nga artistet me linjat më të përkryera. Morena ndonëse nuk është shumë aktive në muzikë, po vazhdon të rrëmbejë vëmendje me imazhet mjaft provokuese që po ndan. Së fundmi këngëtarja ka publikuar disa fotografi të reja nga oborri i vilës së saj në Turqi, ku shihet duke u rrezitur në një palë bikini të zeza. Ajo ngacmoi imagjinatën e ndjekësve dhe dukej edhe më tërheqëse duke lënë një pullë të pambërthyer të bikineve.



Dua Lipa mori vëmendjen me dukjen në festën e ditëlindjes së 25-të



Këngëtarja e njohur shqiptare me famë botërore, Dua Lipa, ka mbushur 25 vjet jetë. Ajo ka festuar në Kaliforni së bashku me të dashurin e saj, Anwar Hadid. Dua e ka rrëmbyer vëmendjen me dukjen e saj, ndërsa me

ndjekësit i ka ndarë disa imazhe nga festa e mbrëmshme. Bukuroshja shqiptare pamjen e ka kompletuar me take të zeza e flokë të kapura, ku falë dizajnit asimetric të fustanit, ka vënë në pah edhe tatuazhet e shumta.

kejvina_kthella



Kejvina Kthella nxjerr pistoletën

Kejvina Kthjella ka pozuar së fundmi me një stil shumë ndryshe nga sa jemi mësuar ta shohim në rrjete sociale. Ajo ka zgjedhur një palë rroba të zeza dhe me një pistoletë e kapuç në kokë,

duket fiks si një "Gansta girl". Kanatierja e hapur dhe e çarë në anë, i nxjerr në pah gjoksin dhe belin e hollë. Mes maskës, sytë e shkruar e bëjnë atë të duket edhe më sensuale.


Luana Vjollca heq të gjitha dyshimet për fotoshop



Këngëtarja dhe moderatorja Luana Vjollca është shfaqur tejet provokuese në fotografiminë e fundit të publikuar në llogarinë e vet në "Instagram". Ajo shpeshherë është akuzuar për fotoshop pasi

format e saj trupore i dilnin seksi edhe në imazhet që publikonte. Tani ajo ka vendosur t'ua mbyllë gojën të gjithëve me një foto dhe video ku është shfaqur në bikini dhe duket tejet joshëse.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Prishtina pret vendim të drejtë nga UEFA



Klubi më i madh në Kosovë, Prishtina, pret një vendim të drejtë nga UEFA për ndeshjen e Ligës së Evropës, Lincoln - Prishtina. "Duhet ta bëjmë maksimumin për ta bindur UEFA-në. Dhe besojmë se UEFA do ta marrë vendimin meritore", ka thënë Bajram Shala, përfaqësues i FC Prishtina

"Epoka e re"

PRISHTINË, 23 GUSHT - FC Prishtina është dashur të përballlet me Lincolnin në kuadër të rrethit parakualifikues në Ligën e Evropës, por ndeshja është anuluar nga autoritetet e Gjibraltarit për shkak se disa futbollistë të Prishtinës kanë dalë pozitivë me Covid-19. Prishtina duhet t'i dëshmojë argumentet në UEFA deri sot (e hënë) në mëngjes, kurse përfaqësuesi i klubit kryeqytetas, Bajram Shala, ka shprehur optimizëm për një vendim të drejtë. Ai ka treguar se skuadra e Prishtinës e kishte për qëllim moslejimin e vendosjes së ndeshjes në tavolinë, por në terren. "E kemi ditur që ishte e pamundshme të luhet, por kemi bërë 'luftë' që mos të kishte vendim nga UEFA, që mos të regjistrohej me rezultat zyrtar dhe ta dërgojmë lëndën në Komisionin e Etikës dhe Disiplinës, për të cilën kemi afat deri të hënën në orën 8.00 të mëngjesit. Duhet cekur të gjitha

faktet, sidomos sakrificën që e ka bërë klubi me organizimin e një ekipi komplet të ri që është dëshmi e jashtëzakonshme që Prishtina ka tentuar në çdo formë që ndeshja të përcaktohet në terren dhe jo në tavolinë. Nuk është e vërtetë s'i kanë aluduar vendësit, që është vendim i UEFA-s, sepse ne e kemi të shkruar nga ana e delegatit vendimin që për pezullimin e ndeshjes ka ardhur nga autoritetet lokale", ka thënë Shala. "Duhet ta bëjmë maksimumin për ta bindur UEFA-në. Dhe besojmë se UEFA do ta marrë vendimin meritore. Por, ne duhet ta cekim komplet historikun nga java e kaluar, nga ndeshja e parë kur është dashur të zhvillohet. Dhe, Prishtina në çdo formë ka dëshmuar se dëshiron të luajë duke krijuar ekip të ri e duke mos tentuar as të ankohej pas anulimit të ndeshjes së parë e duke mos kërkuar rezultat në tavolinë e, siç po duket, mjaft haptas ka qenë qëllimi i Lincolnit", ka thënë Shala.

Ndërsa trajneri i Prishtinës për këtë

ndeshje, Ramiz Krasniqi, beson se UEFA do të marrë një vendim korrekt sa i përket ndeshjes Lincoln - Prishtina. "Unë jam seleksionues i Përfaqësueses së Kosovës dhe nuk më lejohet të flas për ndonjë dyshim. Por, në të vërtetë, shumë gjëra nuk kanë shkuar ashtu siç duhet. Ne i kemi pasur 10 futbollistë për të luajtur, duke shtuar edhe futbollistin që doli pozitiv si të 11-në, i cili kishim argumentin se kishte kaluar virusin para shumë javësh. Por, autoritetet vendëse nuk lejuan, duke këmbëngulur që mos të luhet me asnjë kusht ndeshja. Sinqerisht, kemi qenë në nivel të duhur në çdo pikëpamje, në sjellje duke qenë korrekt maksimalisht, në çdo procedurë dhe besoj në korrektesinë e UEFA-s, sidomos duke pasur parasysh dy herë rresht udhëtimin me shpenzime enorme nga klubi dhe sakrificën e lojtarëve, për çka i falënderoj shumë, duke treguar që ne kemi dashur ta përfundojmë ndeshjen në tapetin e blertë, ashtu siç rekomandon UEFA", ka deklaruar Krasniqi.

SHKURT

Arbëria vazhdon përgatitjet në Pogradec

KF Arbëria përgatitjet për edicionin e ri në IPKO Superligë po i vazhdon në Pogradec të Shqipërisë. "Sigurisht jemi në një çast të rëndësishëm të përgatitjeve të larta fizike dhe unë me stafin tim jemi te fokusuar drejt objektivit tonë. Të gjitha i kemi përmbledhur në një tërësi, duke pasur kujdes për intensitet dhe elementet tekniko-taktike", ka thënë Arbnor Morina. Në Pogradec, Arbëria, përveç përgatitjeve, do të zhvillojë edhe disa ndeshje miqësore.

Drenica 'blindon' Ymerin dhe Tahirin

Skuadra e Drenicës është duke vijuar konsolidimin e skuadrës për edicionin e ri futbollistik 2020/2021. Skuadra kuqezi ka rinovuar kontratat me dy futbollistë shumë të rëndësishëm. "Portieri Arion Ymeri dhe sulmuesi anësor Hysen Tahiri kanë firmosur kontratat njëvjeçare me klubin dhe të dy i mbesin besnik klubit të tyre të zemrës. Në ditët në vazhdim do të ketë edhe prezantime të tjera, varësisht nga marrëveshjet që do të arrihen. Drejtuesit e klubit janë duke punuar në vazhdimësi për konsolidimin e skuadrës dhe stafit për të qenë sa më të përgatitur për edicionin e ri të garave 2020/21", thuhet në njoftimin e Drenicës.

Drita transferon Azemin

Mesfushori Valmir Azemi është futbollist i ri i kampionës së Kosovës, Dritës. Drita të dielën ka njoftuar për angazhimin e Azemit që deri më tani ka luajtur për Vushtrrinë. Sipas vlerësimit të klubit gjilanas, Azemi ka bërë një hap të madh në karrierë. "Valmiri si lojtar i dalluar në mesfushë ka bindur me paraqitjet te Vushtrria që ta ofrojmë në ekip. Do të jetë forcë shtesë në grupin tonë. Valmiri tashmë është bashkuar me ekipin dhe po vazhdon përgatitjet për sezonin e ri", ka njoftuar Drita.

Oliveira triumfon në Austri

Miguel Oliveira është fitues i Çmimit të Madh të Austrisë në MotoGP. Pas një gare me plot emocione, ishte portugezi Miguel Oliveira që ka arritur të triumfojë në fund. Jack Miller është renditur i dytë, ndërsa spanjollit Pol Espargaro në vendin e katërt. Pas 11 garave, është Fabio Quartararo që kryeson me 67 pikë, i ndjekur nga Andrea Dovizioso me 56 pikë dhe Maverick Vinales me 48 pikë. Gara e radhës mbahet në Itali, më 13 shtator.

Kabashi: Topalli, Baftiu dhe Hoxha transferohen në Turqi

SUHAREKË, 23 GUSHT - Tre yjet e skuadrës së Ballkanit, Jetmir Topalli, Blend Baftiu dhe Arbër Hoxha, karrierën futbollistike do ta vazhdojnë në Turqi. Lajmin e ka konfirmuar

presidenti i FC Ballkanit, Arsim Kabashi. "Tre superd-jelmoshat po ikin në Superligën turke. Gjatë javës së ardhshme gjithçka do të dihet 100 %. Me dëshirën

time këta të tre luan i kisha mbajtur në Ballkan deri në pensionim, por duhet t'i përkrahim me të gjitha forcat tona që ëndrrat e tyre mos të mbesin veç 'ëndërr', edhe

nëse neve ndonjëherë nuk na bie mirë", ka shkruar Kabashi në profilin e vet në "Facebook". Kabashi është i bindur se kjo treshe do ta bëjë krenare Kosovën.



Mavraj, pas tetë vjetësh tërhiqet nga Kombëtarja e Shqipërisë

TIRANË, 23 GUSHT - Mbrojtësi Mërgim Mavraj ka vendosur që ta përfundojë karrierën në Kombëtaren e Shqipërisë. 34-vjeçari nuk ka qenë pjesë e kuqezinjve në disa prej ndeshjeve të fundit, pasi ishte i lënduar. Të dielën vetë mbrojtësi ka bërë një postim në "Instagram", ndërkohë që shkruan "Mirupafshim". Mesazh i qartë, që flet vetë dhe që ua hap rrugën të rinjve për të pasur më shumë mundësi në kombëtaren shqiptare. "Unë dua të them faleminderit Zot. Përsëritet! Kanë kaluar gati tetë vjet që prej shtatorit të 2012-s kur debutova për herë të parë me Kombëtaren Kuq e Zi, vite të cilat mbase nuk janë të shumta, porse emocionet, sfidat, sakrificat, rëniet, ngritjet dhe sukseset kanë qenë më se të mjaftueshme për të skalitur në brendësinë time përjetime të rralla dhe të pashlyeshme. Ky rrugëtim më ka ofruar mundësinë që ta njoh edhe më mirë vendin tim, njerëzit e vendit tim, por dhe vetë veten time dhe jo vetëm, si shkak i këtij rrugëtimi, edhe sportin arrita ta njoh dhe më mirë. Mirëpo si çdo rrugëtim dhe ky e ka një fund, dhe ky fund është më se i lumtur. Ndaj për këtë dëshiroj t'i falënderoj të gjithë bashkëshoqëruesit e mi duke filluar nga familja ime, miqtë e



mi, ndjekësit e kombëtares kuq e zi, presidentin Armando Duka, kolegët e mi dhe të gjithë stafet teknike me të cilët kam punuar, edhe pse gjithsecili prej tyre meriton një falënderim personal. Jam i detyruar që të gjithë falënderimet t'i përmbledh në këta pak rreshta.

Mbi të gjitha falënderimet, është falënderimi ndaj Zotit, i cili ma mundësoj këtë fund të lumtur. Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe popullin tonë shqiptar! Zoti na e mundësoftë që Një Flamur të jetë simboli ynë! Përzemërsisht, Mërgim Mustafë Mavraj", ka shkruar Mavraj.

Lakersat në epërsi ndaj Portlandit

ORLANDO, 23 GUSHT - Los Angeles Lakers "fluturon" me dyshen LeBron James-Anthony Davis. Kalifornianët fituan ndeshjen e tretë ndaj Portland Trail Blazersit me shifrat 116-108, duke marrë në 2-1 kryesimin e serisë së përbaljes mes tyre. James ishte lider i vërtetë në këtë sfidë teksa ishte thjesht "monstruoz" me 38 pikë, 12 rebounde dhe 8 asistime, edhe Davisi shkëlqeu me 29 pikë, 11 rebounde dhe 8 asistime. Të pamjaftueshme ndërkohë 34 pikët e realizuara nga Damian Lillard për Portlandin që tashmë duhet të mendojë për ndeshjen e radhës. Rihapi garën në përbaljen tjetër çerekfinale në Perëndim, Oklahoma City Thunder, që mposhti pas kohës shtesë me rezultatin 119-107 Houston Rocketsin. "Në HP Field House" të Orlandos dallimin e bëri loja në grup e City Thunderit, ku plot 4 basketbollistë të City Thunderit



realizuan 20 pikë e sipër. Spikati gjermani Denis Schroder me 29 pikë, ndërsa u ndihmua edhe Chris Paul me 26 pikë të tjera. Për ta evituar humbjen e parë në përbaljen ndaj Oklahomës, Houstonit nuk i mjaftuan 38 pikët e James Hardenit. Një super Giannis Antetokounmpo mori për dore Milwaukee Bucks që tashmë kryeson 2-1 serinë ndaj Orlando Magicut. Greku ishte i jashtëzakonshëm duke realizuar 35 pikë, 11 rebounde

dhe 7 asistime. Një sukses me shifrat 121-107 për Bucksin që tanimë duhet të fitojë dhe dy sfida të tjera për të shkruar në gjysmëfinalet e Lindjes. Miami Heat ndërkohë pothuajse është në fazën tjetër të "play-off"-it pas fitores së tretë radhazi që mori ndaj Indiana Pacersit, këtë herë me rezultatin 124-115, ku dy më të mirët mbi parket për skuadrën nga Florida ishin Jimmy Butler dhe Goran Dragic që së bashku koleksionuan 51 pikë.

SHKURT

Ronaldo këshillon Realin: Transferojeni Mbappen, jo Neymarin

Drejtimesit e Real Madridit po mendojnë të bëjnë një blerje të madhe për sezonet e ardhshme. Neymar dhe Mbappe janë dy emra që qarkullojnë gjithmonë në ambientin madrilen. Një këshillë për "Los Blancos" ka ardhur nga Fenomeni. "Mendoj se Neymari dhe Mbappe janë në të njëjtin nivel tani", ka thënë Ronaldo. "Po nëse Real Madridi ka ndërmend të bëjë një investim të madh për të blerë një lojtar, duhet ta bëjë duke menduar për të ardhmen", ka shtuar sulmuesi brazilian. "Neymari është 28 vjeç dhe Mbappe 22. Do të ishte më logjike që të provonte të merrte Mbappen".

Dështon transferimi i Cavanit te Benfica

Pas skadimit të kontratës në muajin qershor, Edinson Cavani preferoi të largohej menjëherë nga Paris Saint Germaini dhe të mos luante ndeshjet e Ligës së Kampionëve, ndërsa prej më tepër se një muaji po shijon pushimet me familjen e tij. Ishte pritur që Cavani të transferohej te Benfica, por kjo e fundit i kishte ofruar një kontratë trevjeçare me pagë rreth 8 milionë euro në sezon, por menaxherët e Cavanit rritën pretendimet në çastet e fundit, duke kërkuar 10 milionë euro në sezon dhe gjithçka dështoi.

Parma shkarkon trajnerin

Skuadra nga Seria A, Parma, ka vendosur t'i ndajë rrugët me trajnerin Roberto D'Aversa. Lajmi është bërë me dije nga skuadra e Parmës përmes një komunikate. "Parma njofton se Roberto D'Aversa është liruar nga roli i trajnerit të ekipit të parë", thuhet në njoftim. Më tutje, thuhet se trajnerit kohën e fundit i kanë munguar kohezioni, uniteti i synimit dhe entuziazmi. Sezonin 2019/2020 Parma e ka përfunduar në vendin e 11 me 49 pikë.

Reina, lojtari më i ri i Lazios

Portieri Pepe Reina do të jetë lojtari më i ri i Lazios, ku do të jetë zëvendësues i Thomas Strakosha. Sipas mediave italiane, marrëveshja mes portierit në pronësi të Milanit dhe Lazios është arritur dhe spanjollit do të nënshkruajë një kontratë 2-vjeçare. Kujtojmë se Pepe Reina u huazua nga Milani te Aston Villa në merkaton e janarit, teksa u kthye përsëri te kuqezinjët pas përfundimit të huazimit, por duket se nuk do të qëndrojë për shumë gjatë aty.

Mihajloviqi infektohet me Covid-19

Trajneri i Bolognas, Sinisa Mihajloviq, ka rezultuar pozitiv në testin për Covid-19. Lajmi është dhënë nga vetë klubi italian përmes faqes së vet. Trajneri është asimptomatik, por do të qëndrojë në izolim për të paktën dy javë sipas protokollit të koronavirusit. "Pasi u kthye në Bologna të premtën, Sinisa Mihajloviq ka dalë pozitiv me koronavirus. Trajneri ynë nuk ka simptoma, por do të qëndrojë në izolim për dy javët e ardhshme në përputhje me udhëzimet e autoriteteve. I gjithë grupi i ekipit të të rinjve iu nënshtrua testeve mjekësore në ditët e shkuara dhe rezultatet ishin të gjitha negative. Lojtarët e ekipit të parë dhe stafi do të testohen sërish", shkruhet në deklaratën e Bolognës.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrypa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

- ▶ Meralj Hamza shpall te pavlefshme diplomën shmm "Luciano Motroni" Prizren
- ▶ Sulltane Arifi shpall te pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Veton Mekan shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Altin Kryezi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Nazmi Kokollari Budakova" Prizren
- ▶ Mentor Qafleshi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Fadil Hisari" Prizren
- ▶ Behar Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Mendim Gashi nga Prishtina, shpallë te pavlefshme dëftesat e klasës së -X- dhe -XI- te shkollës "Sami Frashëri" Prishtinë
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Dy vjet pa ty Nënë e dashur!



Arife (Morina) Krasniqi

(01.09.1949 - 24.08.2018)

Edhe pse je në atë botë, ne këtu ndiejmë mall, mall që kurrë nuk do të shuhet. Pusho e qetë Nënë, se ne nuk do të harrojmë kurrë. Vdekja jote është mungesë e pazëvendësueshme, dhembje e pashëruar. Malli për ty do të mbetet gjithmonë pjesë e jetës sonë. Vlera jote është e madhe. Atë e dimë vetëm Ne që mbetëm pa Ty.

Më mall të kujtojnë: Djemt, vajzat, rejat, nipat dhe mbesat nga Tërpeza e Malishevës, Gjermani, Suedia, Franca e Prishtina.